



UNIVERSITETI I ARTEVE

**RAPORTI VJETOR
I VEPRIMTARISË MËSIMORE,
ARTISTIKE-KËRKIMORE-SHKENCORE
DHE FINANCIARE
VITI AKADEMIK
2019-2020**



**SENATI AKADEMIK
TIRANË, SHKURT 2021**

HYRJE

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në Udhëzimin nr. 5, datë 19.02.2018, të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor...”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.24, datë 21.10.2019, Universiteti i Arteve, Tiranë, paraqet Raportin vjetor të veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore dhe financiare për vitin akademik 2019-2020, në nivel universiteti, në kuadër të informimit dhe transparencës për veprimtarinë e tij.

Kjo analizë duhej të përfundonte në muajin dhjetor (sipas udhëzimit nr.5 të MASR, i ndryshuar) por për shkak të situatës së krijuar nga Covid 19, procesi mësimor dhe aktivitetet e tjera të Universitetit të Arteve u shtynë. Për këtë arsye, analizat vjetore në nivel njësie kryesore u zhvilluan në muajin Janar 2021, ndërsa analiza vjetore në nivel universiteti u zhvillua në muajin Shkurt 2021.

Misioni i Universitetit të Arteve, Tiranë përfshin: ofrimin e arsimit të lartë profesional dhe veprimtarisë krijuese në fushën e artit dhe kulturës; zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike që kryhet brenda dhe jashtë vendit; formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e kulturës; thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e kulturës; kryerjen e studimeve artistike-kërkimore-shkencore për të zhvilluar e tejçuar artin e kulturën; ndihmesën në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit dhe cilësisë së shoqërisë si dhe përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

Universiteti i Arteve përfshin në trashëgiminë e vet të vyer, eksperiencën e shkëlqyer të Konservatorit të Muzikës të krijuar në vitin 1962, Institutit të Arteve të Bukura të krijuar në vitin 1959, Shkollës së Teatrit të krijuar në vitin 1959, Institutit të Lartë të Arteve të krijuar në vitin 1966 dhe Akademisë së Arteve të krijuar në vitin 1991.

Universiteti i Arteve, është krijuar në zbatim të VKM nr.234, datë 23.01.2011.

Universiteti i Arteve përmbledh një tërësi vlerash artistike, kulturore, akademike dhe shoqërore, të krijuara dhe formësuara prej një kohe të gjatë e prej një mori brezash të njëpasnjëshëm të pedagogëve, studentëve, artistëve e personaliteteve nga më të shquarat.

Universiteti i Arteve është nxitës dhe nismëtar i zhvillimeve artistike e kulturore në Shqipëri dhe në gjithë hapësirat e banuara nga shqiptarët, për të përmbushur ruajtjen, mbrojtjen dhe pasurimin e trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar, me qëllim rritjen e kontributit tonë për shtimin e vlerave kulturore në hapësirat gjeografike e politike europiane e botërore.

Universiteti i Arteve ofron programe në dy ciklet e studimit me kohë të plotë, në përputhje me standardet me të larta akademike dhe profesionale, në përgatitjen e profesionistëve në fushën e arteve. Në zbatim të misionit të Universitetit të Arteve si dhe kuadrit ligjor në fuqi, ky raport synon të paraqesë aspektet kryesore të aktivitetit akademik në UART, duke vënë theksin edhe tek problematikat e evidentuara dhe të adresuara për zgjidhje, me qëllim rritjen e mëtejshme të cilësisë.

Ky raport bazohet në raportet analitike të njësisë kryesore (fakulteteve) të Universitetit të Arteve, si dhe të strukturave të tjera të UART.

Raporti paraqet në mënyrë të përmbledhur aktivitetin në tërësi të Universitetit të Arteve. Një kopje e këtij raporti dërgohet në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe një kopje publikohet në versionin elektronik në faqen zyrtare të internetit të UART.

Raporti vjetor është një pasqyrë e aktivitetit akademik (2019-2020) dhe aktivitetit financiar, të zhvilluar nga Universiteti i Arteve, Tiranë. Raporti paraqet dhe pasqyron në formë të përmbledhur informacione, analiza dhe gjetje për: funksionimin dhe performancën e strukturave përgjegjëse (organe kolegjiale, komisione të përhershme) në lidhje me aspekte të ndryshme të veprimtarisë akademike dhe financiare të UART dhe të fakulteteve; procesin e mësimdhënies dhe të nxënit, njohuritë dhe kompetencat në nivel njësie kryesore; projektet ku personeli i UART merr pjesë si palë aktive, përqindjen e të diplomuarve; numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit, numrin e studentëve që ndjekin programet e studimit që ofron UART, mbështetjen për studentët (bursa apo përjashtim/reduktimi i tarifave të shkollimit), pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre, cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi; mobilitetin e personelit akademik të realizuar në kuadër të projekteve, përmirësimit dhe plotësimit, sipas standardeve shtetërore të cilësisë. plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukurore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen mjediset didaktike, artistike-kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimin, pagesat për pagat, sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Ky raport është hartuar referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësitë kryesore të UART si dhe nga sektorët e tjerë.

Në mbledhjet e organeve kolegjiale dhe drejtuese ndiqen procedura dhe protokolle të përcaktuara, të UART, në plotësimin e kërkesave të ligjit nr. 80/2015 si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

UART ka si prioritet fuqizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, reflektuar kjo dhe në miratimin e një strukture të posaçme për sigurimin e cilësisë. Nga burimet në dispozicion të UART, konstatohet se është treguar përgjegjshmëri në përmbushjen e detyrave përkatëse nga strukturat përgjegjëse. Kurrikula që ofron Universiteti i Arteve, Tiranë, është e lidhur ngushtësisht me kërkesat e profilizuara të saj dhe mbështetet nga një staf akademik tejet profesional. Programet e studimit janë qartësisht të përcaktuara dhe të përshtatshme me tregun, kjo në përmbushje të misionit që vetë UART ka në “...ofrimin e arsimit gjithëpërfshirës të studentëve, të kualifikimit të tyre artistik si dhe veprimtarive të tjera në fushën e arteve”.

UART ofron programe në dy ciklet e studimit, në përputhje me standardet më të larta akademike dhe profesionale, në përgatitjen e profesionistëve në fushën e arteve. Megjithatë, për shkak dhe të natyrës tejet specifike të programeve të studimit që ofron UART, duhet një qasje me efektshmëri në të gjithë kurrikulat, e shoqëruar kjo me procedurat përkatëse, për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm në cilësinë e mësimdhënies, si për stafin e ri, ashtu edhe për atë me përvojë, duke marrë parasysh praktikën më të mira ndërkombëtare. Për sa i përket ciklit të tretë të studimeve doktorale, UART, ka ndjekur hapat e tij në kërkimin e një marrëveshjeje me ministrinë përgjegjëse për arsimin për krijimin e një cikli të tretë studimi ku peshën kryesore duhet ta mbajë krijimtaria artistike dhe pjesa tjetër të jetë ajo kërkimore studimore. Deri më sot kjo marrëveshje nuk është arritur akoma.

Universiteti i Arteve, Tiranë, është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.234, datë 23.01.2011 “Për krijimin e Universitetit të Arteve, Tiranë (UART)”.

Universiteti i Arteve përbëhet nga Rektorati, Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Artit Skenik dhe Fakulteti i Arteve të Bukura.

Rektorati organizohet dhe funksionon sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe akteve të tjera nwnligjore;

Fakulteti i Muzikës përbëhet nga 3 njësi bazë:

Njësia bazë “Interpretimit”;

Njësia bazë “KMDP”;

Njësia bazë “Kanto”;

Fakulteti i Artit Skenik përbëhet nga 3 njësi bazë:

Njësia bazë “Aktrimi & Teori”;

Njësia bazë “Regji dhe Regji Filmi & TV”;

Njësia bazë “Skenografi – Koreografi”;

Fakulteti i Arteve të Bukura përbëhet nga 3 njësi bazë:

Njësia bazë “Arteve të Aplikuara”;

Njësia bazë “Pikturës”;

Njësia bazë “Skulpturës”;

Funksionimi i organeve kolegjiale dhe drejtuese kryhet në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Çdo njësi, strukturë, personel akademik, ndihmës akademik, dhe jo akademik është përgjegjëse për mbarëvajtjen e procedurave, aktiviteteve dhe veprimtarive që zhvillon Universiteti i Arteve për realizimin e objektivave dhe zhvillimin e procesit mësimor, atij artistik-shkencor, si dhe aktiviteteve të tjera.

Senati Akademik ka ushtruar kompetencat e tij për mbarëvajtjen e veprimtarisë akademike gjatë gjithë vitit akademik, nëpërmjet vendimeve të marra në mbledhjet përkatëse, të cilat i janë adresuar njësive përkatëse për zbatim.

Bordi i Administrimit ka ushtruar kompetencat e veta në mbarëvajtjen e veprimtarisë financiare të UART, nëpërmjet vendimeve të marra.

Rektorati, dekanatet siorgane kolegjiale, në ushtrim të kompetencave të tyre, kanë shqyrtuar dhe marrë vendime lidhur me strukturën e vitit akademik, komisionet për monitorimin e konkurseve të pranimeve, regjistrimeve të reja, transferimin e studimeve, komisionet për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, etj. Po ashtu janë propozuar dhe miratuar grupe pune, komisione apo grupe të posaçme në nivel universiteti.

Këshilli i Etikës si organ kolegjial, nuk ka pasur raste të adresuara këtij organi lidhur me mosrespektimin të kërkesave të moralit dhe të etikës në realizim të funksionit të detyrave të individëve.

Njësitë administrative, ndihmës akademike, rektorati, dekanatet si dhe komisionet ad-hoc të ngritura në rang Rektorati, në ushtrim të kompetencave të tyre, kanë zbatuar vendimet e organeve kolegjiale apo drejtuese.

FAKULTETI I ARTIT SKENIK

Dekanati i Fakultetit të Artit Skenik mori në shqyrtim punën dhe rezultatet e arritura, në lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor, kërkimor e krijues si dhe atë administrative, për vitin akademik 2019-2020. Analiza u realizua në të gjithë departamentet dhe strukturat përbërëse të FAS. Padyshim që diskutimet kishin në qendër të tyre zhvillimin cilësor të procesit të mësimdhënies, rezultatet e arritura në projekte e provime nga studentët e pedagogët si dhe punën e bërë nga sektorët e tjerë ndihmës në fakultet për mbështetjen e tyre.

Mbi procesin mësimor e krijues të vitit akademik 2019-2020 në Fakultetin e Artit Skenik

Fakulteti i Artit Skenik si pjesë e rëndësishme e Universitetit të Arteve ka për mision edukimin profesional artistik, realizimin e projekteve artistike dhe shkencore në fushën artit skenik. Misioni i tij lidhet me formimin artistik duke u mbështetur fort në ruajtjen e traditës si dhe në garantimin e nivelit të lartë dhe cilësor në të gjitha programet e studimit që janë në fakultetin tonë.

Fakulteti i Artit Skenik në Universitetin e Arteve ka qenë dhe synon të mbetet qendra më e madhe dhe më cilësore e edukimit universitar, pasuniversitar, krijimit, kërkimit dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të specialistëve të fushës së artit skenik. Rëndësi i është kushtuar ndërthurjes së edukimit në procesin e mësimdhënies me kërkimin dhe projektet artistike. Ne jemi përpjekur të përgatisim krahas artistëve të kualifikuar edhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë.

Në jetën e tij akademike e krijuese, Fakulteti i Artit Skenik është përballur me sfida të mëdha nga vetë studentët, punëdhënësit dhe shoqëria.

Fakulteti i Artit Skenik e ka mbështetur punën e tij metodike e krijuese në tre boshte kryesore të cilët janë:

- *Për edukimin dhe kualifikimin artistik (të studentëve profesionistë, mësuesve të shkollave të sistemit para universitar për lëndët që kanë të bëjnë me artin skenik, dhe të gjithë atyre që operojnë në këtë fushë)*
- *Për promovimin e vlerave artistike (aktivitete kulturore dhe artistike si dhe botime për të nxjerrë në pah dhe orientuar tregun drejt vlerave njerëzore dhe produktit të tyre)*
- *Për rritjen e aftësisë për menaxhimin më të mirë të karrierës dhe orientimin drejt kërkesave të tregut.*

Fakulteti i Artit Skenik ka qenë dhe vazhdon të jetë i fokusuar në këto problematika të rëndësishme:

- Ruajtjen dhe rritjen e mëtejshme të cilësisë në mësimdhënie;
- Programet e reja të studimit.
- Rritjen e nivelit profesional dhe artistik të personelit akademik;
- Përfshirjen e aktivitetit artistik të saj në kalendarët jo vetëm kombëtar por dhe ndërkombëtar;

- Ndërtimin e laboratorëve bashkëkohore në atelie, studio, salla për të pesë programet e studimit në fakultet;
- Vendosjen e një rrjeti bashkëkohor të informacionit dhe digitalizimin e sekretarisë mësimore;
- Zhvillimin e mëtejshëm të debatit për kurrikulat dhe zhvillimet bashkëkohore të artit skenik;
- Përshtatje e mëtejshme me tregun nëpërmjet hapjes së programeve të reja të studimit.

Ne kemi katër qëllime strategjike:

Zgjerimi i aksesit nëpërmjet programeve të reja

Forcimi i mësimdhënies duke ndertuar laboratore bashkekohore

Shtimi i projekteve artistike dhe shkencore

Rritja e kontributit në jetën kulturore artistike te vendit

Në Fakultetin e Artit Skenik kemi tre Njësi Bazë (Departamente) e konkretisht:

- Departamenti Aktrim dhe Teori,
- Departamenti Regji, Regji Filmi dhe TV,
- Departamenti Skenografi-Kostumografi dhe Koreografi.

Në këto Departamente në dy ciklet e studimit aktualisht kemi 5 (pesë) programe studimi si më poshtë :

Cikli i parë Bachelor

Cikli i dytë “Master i Arteve”

1. Aktrim
2. Regji
3. Skenografi-Kostumografi
4. Koreografi
5. Regji Filmi & TV

1. Aktrim dhe Mësuesi
2. Regji Teatri dhe Spektakli dhe Mësuesi
3. Skenografi-Kostumografi dhe Mësuesi
4. Koreografi dhe Mësuesi
5. Regji Filmi & TV dhe Mësuesi

Reforma e kurrikulave në programet e studimit të Fakultetit të Artit Skenik është realizuar duke pasur parasysh një sërë kërkesash, të cilat i ka diktuar e tashmja dhe e ardhmja e fushës ku veprojmë dhe tregut artistik. Objektivat e veprimtarisë sonë në fushën e reformës së kurrikulave, ndër të tjera kanë synuar që kurrikulat:

Të vazhdojnë të jenë konkurruese;

Të pajisin studentët me dijet dhe aftësitë e duhura.

Të mundësojnë që studentët të jenë më konkurrues në tregun e punës pas diplomimit të tyre;

Të ofrojnë fleksibilitet të mjaftueshëm për zhvillime në të ardhmen dhe për të bërë përshtatje në përputhje me ndryshimin e kushteve;

T'u mundësojnë studentëve vazhdimësi studimi gjatë gjithë jetës;

Të sigurojnë raporte të drejta në mes formimit teorik dhe praktik të studentëve;

Të mundësojnë aktivitete plotësuese që janë të nevojshme për përvetësimin sa më të mirë të programeve mësimore;

Të jenë tërheqëse për një numër sa më të madh studentësh;

Të jenë të përballeshme nga stafi akademik;

Përmes kësaj reforme ne kemi synuar që të eliminojmë dobësitë që ekzistojnë dhe me përkushtim po punojmë që të mundësojmë:

Vazhdimësi të studimeve në nivel universitar dhe pasuniversitar;

Nivel më të lartë në drejtim të formimit profesional të studentëve;

Përshtatje me kërkesat dhe mundësitë e tregut të punës për diplomat që ofron Fakulteti i Artit Skenik;

Më shumë nxitje për mobilitete (për studentët dhe për stafin akademik);

Nxitje e bashkëpunimit evropian në projekte të përbashkëta por sidomos në sigurimin e cilësisë,

Zhvillimin e kurrikulave,

Bashkëpunim ndërinstytucional,

Trajnim dhe kërkim të stafit akademik.

Fakulteti i Artit Skenik gjatë vitit akademik 2019-2020 u mobilizua të realizojë dokumentacionin bazë për rifillimin e vitit të ri akademik.

U rishikuan planet mësimore të të pestë programeve të studimit në fakultetin tonë. Tashmë planet mësimore janë të konsoliduara. Rëndësi i është kushtuar në këtë periudhë planifikimit të angazhimit me ngarkesë mësimore të personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm.

Njëherësh, nga anëtarët e personelit akademik të brendshëm janë riparë dhe rikonceptuar programet e lëndëve, për t'ju përgjigjur sa më mirë kërkesave bashkëkohore.

Programet e studimeve janë përmirësuar sipas strukturave në departamente, në formën e diskutimit dhe të reflektimit të zhvillimeve më të fundit, duke marrë si bazë rezultatin e vlerësimit të vitit të kaluar akademik.

Ndryshimet dhe përmirësimet e programeve të studimit, janë bërë në funksion të rritjes së cilësisë, dhe në përputhje me Rregulloret Mësimore të dy cikleve të studimit me kohë të plotë Bachelor, Master i Arteve dhe Statutit të UART.

Në kuadër të zbatimit të planeve e programeve të studimit si dhe rëndësinë e lëndëve profesionale artistike për formimin e përgjithshëm e specifik të studentëve, në të gjitha vitet e studimit në departamentet Aktrim – Teori, Regji dhe Regji Filmi & TV dhe Skenografi-Kostumografi dhe Koreografi, janë përpjekur të rrisin nivelin e mësimdhënies dhe të

përvetësimit të të gjithë elementëve profesionale artistike në to; ndonëse përvetësimi i tyre është një proces i gjatë e në vazhdimësi që kërkon rritje të nivelit të njohurive e shprehive të secilës fushë specifike, për të arritur rezultate optimale të matshme e të krahasueshme me studente të universiteteve të tjerë rajonal dhe më gjerë, përmes një sistemi të ekualivalentimit të vlerave e krediteve.

Edhe gjatë vitit akademik 2019-2020 është vënë re rritje dhe interes i studenteve për lëndët speciale. Në anën tjetër, duhet që këtij interesi e kërkesave në rritje, t'u përgjigjemi edhe me një impenjim e angazhim më të madh të stafit tonë mësimdhënës si dhe një bazë laboratorike të studiove dhe atelieve më të fuqishme për të përligjur një hop më të lartë cilësor në realizimin e projekteve artistike.

Objektivat e programeve të studimit në Fakultetin e Artit Skenik kanë patur në qendër të vëmendjes, pajisjen dhe zhvillimin e një procesi kreativ me studentët mbi njohuritë krijuese e kërkimore për artin skenik, por çka është më e rëndësishmja me realizimin konkret të punëve krijuese në provime e projekte artistike.

Një moment shumë i rëndësishëm i Fakultetit të Artit Skenik janë **projektet artistike e shkencore**.

Fakulteti i Artit Skenik si pjesë e Universitetit të Arteve, është unik dhe shumë i rëndësishëm në drejtimin arsimor, artistik e krijues në Shqipëri dhe i vetmi që ofron diplomë universitare të ciklit të parë e të dytë në fushën e arteve skenike dhe në kinematografi. Ky fakultet ka mbuluar dhe kualifikimin shkencor të artistëve të diplomuar dhe merr pjesë në jetën krijuese me krijimtari të mirëfilltë artistike, jo vetëm me trupat e saj tradicionale, por edhe me projekte të studentëve, pedagogëve, bashkëpunëtorëve të brendshëm e të jashtëm. Profesorati mësimdhënës dhe ai i mjeshtërive që ka Fakulteti i Artit Skenik ka emra të mirënjohur të jetës skenike si: regjisorë, aktorë, skenografë, kostumografë, koreografë e regjisorë filmi. Procesi i mësimdhënies në këtë institucion është shkrirë me atë të përformimit artistik. Pranë Fakultetit tonë kanë funksionuar dhe akoma funksionojnë trupa e teatrit dhe grupe të pavarura studentësh e pedagogësh për baletin.

Ne do të vazhdojmë të këmbëngulim për një mbështetje të posaçme nga shteti në mënyrë që, duke u siguruar kjo mbështetje e merituar financiare ndaj këtyre trupave të gatshme artistike, të mundësohet jo vetëm shpërfaqja e vlerave të këtij potenciali të fuqishëm talentesh njerëzore që Fakulteti i Artit Skenik zotëron, një potencial i përbashkët i studentëve dhe i pedagogëve, por për shumë më tepër: në dobi të jetës skenike të Tiranës e më gjerë.

Ne sigurojmë se kostoja e një projekti artistik tek ne është shumë herë më e vogël se e një projekti që vihet në skenë në çfarëdo institucioni tjetër, sepse shumë veprimtari me nivel cilësor mbeten të mbyllura brenda mureve të saj dhe arkivohen si punë kursesh a diplomash, si mbrojtje gradash a titujsh, megjithëse meritojnë një komunikim publik të gjerë. Çdo buxhet i dhënë për këtë qëllim do të rikthehej në publik me një vlerë shumë më të lartë dhe me një kosto pa dyshim më të ulët. Këto projekte do të kenë impakt të jashtëzakonshëm tek studentët e talentuar që aktualisht studiojnë në Fakultetin e Artit Skenik, por edhe për të gjithë ata të tjerë që kanë mbaruar studimet në institucionin tonë dhe për nga vlerat që kanë shpërfaqur meritojnë të jenë bashkëpunëtorë në këto projekte. Kjo na inkurajon që në zërin e buxhetit ne të kërkojmë të administrojmë më shumë fonde për projekte të mirëfillta artistike. Ato do bëjnë të mundur realizimin e një prej qëllimeve kryesore e pikërisht kontaktin e lidhjen e domosdoshme të studentëve me tregun, me vetë spektatorin.

Ajo çka është më e rëndësishme në këtë proces është të kuptuarit konkret nga ana e stafit pedagogjik dhe atij studentor, që puna konkrete në fakultet dhe në secilin program studimi matet me produksionin artistik në fund të vitit akademik mësimor.

Vlerat konkrete të shkollës sonë artistike mbështeten në realizimet më cilësore të projekteve artistike të cilat janë produksione artistike të kryera nga fakulteti në bashkëpunim me rektoratin e një sërë institucionesh artistike në Tiranë dhe në rrethe. Për të realizuar këto produksione janë shfrytëzuar në maksimum kapacitetet e sallave të UART Black-box i madh dhe i vogël, Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar Eksperimental, Teatri Metropol etj.

Po ashtu disa projekte të studentëve dhe pedagogëve u shpërfaqën cilësisht dhe në rrethet Fier, Vlorë, Shkodër etj., të cilat janë në raporte dashamirësie harmonike me institucionin tonë. Numri i produksioneve artistike, të shfaqura si provime etydeshe dhe projekteve skenike e filmike arrin mesatarisht në rreth 60 të tilla në një vit akademik. Studentet tanë janë gjithashtu pjesëmarrës edhe në aktivitete lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Janë realizuar edhe aktivitete jashtë vendit.

Konkurset e pranimit në FAS në dy ciklet e studimit për vitin akademik 2019-2020 janë zhvilluar përkatësisht sipas rregullave dhe udhëzimeve përkatëse. Janë zbatuar gjithë udhëzimet e MAS. Stafit pedagogjik, anëtarët e komisioneve të pranimit në konkurse dhe personeli ndihmës administrativ ka punuar me përgjegjësi për mbarëvajtjen e tij. Komisionet përzgjedhëse të programeve të studimeve kanë bërë përpjekjet e duhura profesionale për të seleksionuar vlerat më të mira të shfaqura nga kandidatët konkurrentë.

Në vitin 2019 Fakulteti i Artit Skenik pati dhe një projekt tjetër interesant me pjesëmarrje konkrete të pedagogëve të fakultetit e konkretisht me pedagogët e programit të studimit Regji Filmi e Televizioni dhe Skenografi-Kostumografi. **Fakulteti i Artit Skenik** është angazhuar si partner tashmë në disa aplikime për projekte evropiane me universitete dhe institucione të rëndësishme artistike të kontinentit tonë.

Fakulteti i Artit Skenik dhe veçanërisht programi i studimit Skenografi dhe Kostumografi krijoj një aktivitet me projektet Erasmus Plus. Shkuarja e të gjithë pedagogeve të programit të studimit Skenografi dhe Kostumografi në Barcelonë. Intershipi dhe marrëdhënia me katër shkollat e larta artistike të Barcelonës ishte një shkëmbim përvoja mjaft i mirë.

Në këtë program, pedagogët u ballafaqam dhe shkëmbyen eksperiencën me punën dhe nivelin e tyre në procesin e mësimdhënies. Nga ky ballafaqim dhe shkëmbim përvoja, tregon se niveli i profesoratit tone është i barasvlefshëm me to. Kjo gjë mund të thuhet edhe për projektet dhe nivelin artistik të studentëve tanë. Duhet të kujtojmë se infrastruktura e tyre është në një nivel të lartë për të gjithë programet e studimeve. Shpresojmë që ky aktivitet të shtrihet edhe me studentet e programeve të studimit tona.

Gjatë këtij viti akademik 2019-2020, kishim dy fenomene të cilat sollën problematikë dhe sfidë në organizimin normal të procesit mësimor:

- a) Tërmeti
- b) Shfaqja e pandemisë në shkallë botërore.

Me dëmet e shfaqura nga lëkundjet e tërmetit si herën e parë edhe në të dytën, dekanati tregoi përgjegjshmëri maksimale në përballimin e situatës. Pas konsultave me specialistët e fushës dhe shqetësimet tona u bë e mundur dhe së bashku me rektoratin kryerja e riparimeve të

domosdoshme në të gjitha ambientet e fakultetit. Riparimi kryesor u realizua në atelieron e skenografisë.

Shfaqja e Pandemisë KOVIT-19:

Me shfaqjen e shenjave të kësaj pandemia, me datë 9 mars 2020, nga institucionet eprora u urdhërua mbyllja e shkollave dhe kalimi i mësimin online. Kjo situatë ishte mjaft shqetësuese për specifikën e profilit tonë, kryesisht për lëndët speciale artistike.

Megjithatë, me mënyrën e organizimit dhe me përgjegjshmëri të dekanatit u planifikuan mënyrat e realizimit të procesit mësimor në kushtet aktuale.

Kjo mënyrë organizimi u mbështet në:

- a) Fakulteti i kishte realizuar me sukses provimet dhe detyrimet e semestrit të parë, dhe mbi këto vlerësime mbështetej edhe mbarëvajtja e studentëve edhe në vlerësimin e tyre.
- b) Mbështetur në propozimin tonë si edhe në udhëzimet e MARS, u bë e mundur që procesi mësimor të kaloj në dy faza. Faza e parë të mbyllej deri në gusht mësimdhënien dhe provimet me kurset të cilat kishin diplomimin, i treti Bachelor dhe i dyti në Master të realizonin dhënien e diplomave. Faza e dytë, mësimi të organizohej me kurset e para dhe të dyta Bachelor dhe kursin e parë Master.

Organizimi i mësimin online ishte një eksperiencë e re në zhvillimin e procesit të mësimdhënies nga stafi ynë akademik.

Fillimisht javën e parë dhe të dytë u fillua komunikimi dhe konsultimi me studentët me format e WhatsApp. Pas kësaj kohe filloj të funksionoj sistemi Microsoft Teams i ngritur nga Rektorati. Përgjegjshmëria e stafit akademik dhe e studentëve ishte mjaft premtuese që ky sistem i ri komunikimi do të jepte rezultate pozitive.

Sigurisht mbështetur në të gjithë format e komunikimit edhe studentët u përgatitën që provimet ti jepnin online, me filmime, në mënyrë individuale apo me grupe të vogla të organizuara nga në bashkëpunim dhe nën drejtimin e stafit akademik.

Muaji qershor i solli studentët në studio dhe atelier, në të cilën nga dekanati u morën masat duke zbatuar të gjitha rregullat e protokollit kundër KOVID-19.

Diplomat u organizuan në secili departament sipas një planifikimi të mirë organizuar. Gjithshka u krye me sukses, falë punës së mirë të stafit pedagogjik dhe dëshirës së studentëve për tu shfaqur me projektet e tyre artistike sa më mirë.

MASAT E MARRA PËR TË KALUAR ME SUKSES PERIUDHËN E PANDEMISË:

Departamentet e Fakultetit të Artit Skenik, pasi u njohën me urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 104, datë 30.4.2020 për *“Marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020 nga institucionet e arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e Covid 19”*, si dhe te vendimin e rektoratit të UART me nr. 34 datë 04 Maj 2020, *“Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19, në Universitetin e Arteve”*, ndërmorën masat konkrete që do të realizohen për detajimin e procesit që duam të realizojmë në vazhdimësi për përmbylljen e vitit akademik 2019-2020.

Për këtë qëllim Dekanati i Fakultetit të Artit Skenik në datë 05.05.2020 mori vendimin me nr. 75 *“Për Marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19, në Fakultetin e Artit Skenik pranë Universitetit të Arteve”*.

Ne pasqyruam kërkesat tona për strukturat administrative të UART në dobi të ruajtjes së distancimit social si dhe pastërtisë dhe higjienizimit të ambienteve. Një gjë duhet ta bëjmë të qartë : **ne si fakultet nuk zotërojmë struktura dhe mundësi financiare për të zbatuar saktë dhe ashtu siç duhet protokollin e sigurisë për këtë pandemi që ka rënë.** Nga ana tjetër ne bëme gjithë përpjekjet e duhura dhe morëm masat konkrete për planifikimin e procesit mësimor, provimet e mbartura si dhe sezonin e provimeve e mbrojtjen e diplomave seminareve për studentët e vitit të parë dhe të dytë Bachelor dhe për studentët e vitit të parë të studimeve Master. Gjithmonë duke parë mundësinë e dhënies së provimeve në lëndët speciale në mënyrë individuale dhe me grupe të vogla.

Ne si fakultet kërkuam nga administrata e UART një zbatim të rreptë për protokollin e sigurisë si rezultat i pandemisë Covid 19. Të njëjtën gjë i kërkuam edhe punonjësve të fakultetit tonë.

Ne e kemi shprehur shqetësim mungesën e sigurisë në ambientet tona pasi në UART hyn kushdo madje edhe me mjete motorike.

Gjithashtu ne garantuam një koordinim dhe përfshirje të gjithë personelit administrativ të fakultetit për këtë qëllim.

Për këtë arsye u tregua kujdesi i duhur nga ana e administratës së UART për;

- Dezinfektant duarsh përpara ambienteve ku zhvillohet mësim,
- Maska për studentet,
- Sapun larje duarsh,
- Dezinfektim tualetesh dhe klasave periodikisht gjatë ditës,
- Në hyrje të fakultetit si dhe të klasave dhe auditoreve ku do të zhvillohet mësim të afishohen rregullat bazë për mbrojtjen nga Covid 19.

Planifikimi i realizimit të procesit mësimor konform udhëzimeve përkatëse për të realizuar me sukses mbylljen e vitit akademik 2019-2020, periudhë që do të realizohen përsëritjet, konsultimet, seminarët, praktikat, provimet e mbartura si dhe sezoni i provimeve për studentët e vitit të parë dhe të dytë në Bachelor dhe për studentët e vitit të parë të studimeve në Master sipas këtij kalendari të poshtëshënuar:

- a) 31 Gusht-2 Tetor, realizimi i përsëritjeve të lëndëve të specialitetit për secilin program studimi, leksioneve, seminareve dhe punëve laboratorike për studentët e vitit të parë dhe të dytë të ciklit të parë të studimeve Bachelor dhe për studentët e vitit të parë të ciklit të dytë të studimeve Master.*
- b) 21 Shtator-2 Tetor, zhvillimi i provimeve të mbartura, si dhe përgatitja për provimet përfundimtare.*
- c) 3 Tetor-25 Tetor, sezoni i provimeve.*
- d) 26 Tetor-31 Tetor, Sezoni i provimeve të vjeshtës, si dhe përmbyllja e dokumentacionit.*

VITI I- II-TË BACHELOR DHE VITI I I-RË MASTER

- Mësimi do të zhvillohet nga data **31 Gusht-2 Tetor 2020.**
- Provimet e mbartura do të realizohen nga data **21 Shtator-2 Tetor 2020.**
- Provimet do të realizohen nga data **3 Tetor-25 Tetor.**
- Sezoni i provimeve të vjeshtës do të realizohet nga data **26 Tetor-31 Tetor.**

- **Koncepti i realizimit të programit mësimor, të konsultimeve, seminareve, të provimeve të mbartura dhe të provimeve, do të mbështetet nga një mirë-organizim dhe planifikim i këtij procesi prej udhëheqësve të kurseve të secilit program studimi. Në bazë të këtij plani të paraqitur nga secili udhëheqës i kursit pranë departamentit përkatës, do të vepohet.**
- **Do të shfrytëzohen edhe hapësirat në studio, apo atelie që janë krijuar nga mbyllja e provimeve të diplomave të bachelorit dhe të masterit.**
- **Mbi gjithshka do të jetë ruajtja e distancimit fizik, në të gjitha lëndët që do të realizohen në fakultetin tonë.**
- Mësimi do të bëhet me distancim fizik në klasa, atelie, studio e salla, si dhe on-line.
- Lendet që janë detyrim do të përfundojnë me vlerësim në javën e fundit të procesit, duke i marre studentet individualisht.
- Lëndët teorike të cilat janë organizuar dhe zhvilluar online, do të realizojnë përsëritjen në formën on-line në ditët dhe orarin e përcaktuar nga departamentet.
- Proçesi i praktikave profesionale do të realizohen njëherësh me projektet artistike.
- Realizimi i të gjitha provimeve të lëndëve artistike profesionale do të realizohet në varësi të secilit program studimi, pra në specifikat e tyre ato do të realizohen në grupe të vegjël dy, tre student duke u mbështetur në masat që kërkon protokollin shëndetësor në rastin e Covid 19. Në ndonjë rast mundet edhe në skenë, nëse grupi është deri në 4 studente, gjithmonë duke ruajtur distancimin social.

Mënyra e organizimit të procesit mësimor në kushtet e pandemisë:

Të gjithë programet e studimit të FAS realizuan këtë formë të procesit të organizimit dhe zhvillimit të procesit mësimor:

LËNDËT TEORIKE

- Lëndët teorike janë organizuar dhe zhvilluar online, dhe realizuan përsëritjen në formën online në ditët dhe orarin e përcaktuar nga departamenti.

LËNDËT SPECIALE ARTISTIKE

- Këto lëndë janë organizuar në procesin e konsultimeve në grupe të vogla 1 deri në 2 studentë, të ndarë në orare të njëpasnjëshme sipas organizimit dhe planifikimit të pedagogut të kursit të parë dhe të dytë duke ruajtur rigorozisht distancimin social.
- *Secili pedagog kursi paraqiti me përgjegjësi pranë departamentit organizimin dhe planifikimin e zhvillimit të procesit të konsultimeve dhe të realizimit të provimeve i cili u miratua nga shefi i departamentit, gjithmonë duke u mbështetur në rregullat bazë për mbrojtjen nga Covid 19.*

Në kuadër të hartimit të zbatimit të Qeverisë Shqiptare dhe Ministrive të Linjës të dokumentit “Pakti i Studentëve” u krijuan marrëveshjet dhe veçanërisht Fakulteti i Artit Skenik si më poshtë vijon:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Universitetit të Arteve. Për implementimin e dokumentit “Pakti për Universitetin” 08.05. 2019.

Personat e kontaktit nga të dyja palët do të jetë të disponueshëm, do të organizojnë takimet e grupeve të punës, institucioneve specifike, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambli Popullor dhe Ministrisë së Kulturës dhe Universitetit të Arteve. Për implementimin e dokumentit “Pakti për Universitetin” 03.10.2019.

Qëllimi i kësaj marrëveshje është krijimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet TKOBAP, MK dhe UA. Objekti i rregullimit të marrëveshjeve është përcaktimi i detyrimeve respektive të palëve. Universiteti i Arteve do të përcaktojë kordinatorin institucional që do të angazhohet në përzgjedhjen, bashkëpunimin dhe kordinimin e studentëve pjesëmarrës në programet e KTOBAS-së. Të përfshijë studentët e UART, degët Regji, skenografi, koreografi, me aktivitetin e tyre konkrete dhe konkursin “YOUTH THEATRE”, si faze e pare e krijimit të akademisë së Operas nga mosha 17-25 vjeç për sezonin e kalendarit artistik të vitit 2020.

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Universitetit të Arteve dhe Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit dhe Ministrisë së Kulturës dhe Universitetit të Arteve. Për implementimin e dokumentit “Pakti për Universitetin” 24.09.2019.

Universiteti i Arteve do të përzgjedhë çdo vit akademik student të interesuar për intership pranë AQSHF.

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Universitetit të Arteve dhe Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave dhe Ministrisë së Kulturës. Për implementimin e dokumentit “Pakti për Universitetin” 27.06.2019.

Universiteti i Arteve do të përzgjedhë çdo vit akademik për mbrojtje diplome që të jepen në sallën e teatrit. Shkëmbim të stafeve midis dy institucioneve. Realizimin e workshope-ve. QKKF, do të ketë hapësirë për diplomat e skenografisë, regjisë, aktrimit, koreografisë, etj.

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Universitetit të Arteve dhe Galerisë Kombëtare të Arteve dhe Ministrisë së Kulturës. Për implementimin e dokumentit “Pakti për Universitetin” 19.06.2019.

Organizimin e praktikave të studentëve në galeri, si vëzhgues, mirëmbajtës, si edukator për fëmijë, nxënës, student dhe përfshirjen e tyre në projektet e galerisë.

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Universitetit të Arteve dhe Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” dhe Ministrisë së Kulturës. Për implementimin e dokumentit “Pakti për Universitetin” 27.06.2019.

Të angazhohen për thirrje dhe njoftime të TKE KS, ndaj studentëve dhe stafit akademik. UART, do të përzgjedhë për çdo vit akademik, shfaqje për mbrojtje diplome, shfaqjet do të jepen në sallën e TKEKS, në kalendar. TKEKS, ka detyrime të shkëmbimeve të njohurive, stafit dhe infrastrukturës. Shkëmbime përvoja sipas rastit, shkëmbime materialeve studimore, botime, shkëmbim të stafit dhe eksperteve. Për zhvillimin e shfaqjeve, leksioneve, trajnimeve. Pjesëmarrës në produksionet teatrore të TKEKS, aktivitete prezantuese dhe promovuese, bashkëbisedime me studentët, dhënies së lejes për përdorimin hapësirave për përdorimin e ambienteve, për workshope, rekuizitës, kostumeve, dekorit etj.

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Universitetit të Arteve dhe Teatrit Kombëtar dhe Ministrisë së Kulturës. Për implementimin e dokumentit “Pakti për Universitetin” 27.06.2019.

Të angazhohen për t’ju përgjigjur thirrjeve dhe njoftimeve të TK, duke përcjellë të gjitha informacionet te studentët e FAS. Universiteti do të përzgjedhë për çdo vit akademik dy shfaqje të mira për mbrojtje diplome. TK do të ofrojë stazhe dhe praktika për studentët në Festivalin e

shkollave të mesme TR-RIN ART. Të afrojë stazhe dhe praktika për studentët në shfaqjet e ardhshme duke qenë produksione të TK, si regjisor, kostumograf, skenograf, si asistencë. Dhënies së ambienteve sipas mundësive, të rekuizitës, dekorit dhe kostumeve për qëllime akademike dhe për shfaqje diplome. Të garantojnë pjesëmarrjen e studentëve në Forumet e Debatit, për shfaqje që janë produksione të TK, dh workshope me personalitete ndërkombëtare në fushën e Arteve Skenike. Etj.

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Universitetit të Arteve dhe Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore dhe Ministrisë së Kulturës. Për implementimin e dokumentit “Pakti për Universitetin” 08.10.2019.

Kjo marrëveshje realizon praktika për studentët, asistim procedura verifikimi, regjistrimi, qarkullimit kombëtar e ndërkombëtar të çertifikuar të pasurisë kulturore. Të përfshije dhe angazhojë student të asistojnë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

Filloj angazhimi për implementimin e tyre si:

1. Stazhe dhe praktika për studentët tanë në Festivalin teatror të shkollave të mesme **TK-RIN ART**
2. Stazhe dhe praktika në sektorin skenografi, kostumografi dhe as. regji për secilën shfaqje të zhvilluar në kuadër të **TK-RIN ART**.
3. Stazhe dhe praktika si as. Regji, as. Kostumograf, as. Skenograf, në shfaqjet e ardhshme që do të jenë produksione të Teatrit Kombëtar.
4. Audicione në shfaqjet e Teatrit Kombëtar
5. Çeljen e **Ateliesë të të rinjve** në skenë e re arTurbina e cila do të mirëpresë dhe promovojë studentët e tanë.
6. Përzgjedhja në bazë të një konkursi të shfaqjeve të artistëve të rinjtë, për të qenë pjesë e Kalendarit Artistik të Teatrit Kombëtar.
7. Mirëpritja e shfaqjeve më të mira të diplomave të studentëve për tu shfaqur në Skenën e Re arTurbina.
8. Bashkëpunim i ngushtë me Universitetin e Arteve dhe pjesëmarrjen e studentëve në Forumet e Debatit për shfaqjet që janë produksion i TK.

Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Universitetit të Arteve për Implementimin e dokumentit “Paktit për Universitetin”

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është krijimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Universitetit të Arteve me qëllim dhe në funksion të zbatimit sa më të suksesshëm të “Paktit për Universitetin”, duke përcaktuar rregulla, përgjegjësi dhe detyrime konkrete për secilën nga palët.

Gjatë vitit 2019 Fakulteti i Artit Skenik aplikoj me disa projekte për laboratorë pranë Agjencisë Kombëtare të kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe fitoj për zbatim projektin “Laboratori i Regjisë së Filmit dhe Televizionit”.

Bashkëpunim i fakultetit tonë me Shoqatën e Artistëve të Skenës për Festivalin Teatror të Shkollave të Mesme të Tiranës. Fakulteti i artit Skenik ishte bashkëpunëtor në këtë festival me pedagogë anëtarë jurie, si dhe me bisedat të zhvilluara çdo mbrëmje për teatrin dhe artin e interpretimit. Po ashtu gjatë këtyre mbrëmjeve u dhanë informacione rreth shkollës sonë.

Aktiviteti “Ditët e Informimit të Maturantëve” u zhvillua në Qendrën Rinore TEN. Ky aktivitet ishte i rëndësishëm për fakultetin tonë, pasi ka të bëjë me informimin e maturantëve për

programet tona të studimit dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të procesit pranë specialiteteve tona.

Në kuadër të Paktit për Universitetin, Fakulteti i Artit Skenik ka kryer takime me përfaqësues Ministrinë e Kulturës ku ka paraqitur nevojat për investime në ambiente mësimore (klasa, atelier, studio etj.), ambiente studimi, salla leksioni, ambiente për personelin akademik dhe atë administrativ etj.

Për prioritetet në kërkesat për investime kemi patur parasysh:

- *të plotësojmë nevojat tepër urgjente që ka sot Fakulteti i Artit Skenik për një zhvillim normal të mësimit dhe njëkohësisht të përforcojmë infrastrukturën e mësimdhënies në ato ambiente ku është më e domosdoshme, (studiot dhe klasat e fakultetit, salla e madhe e koncerteve dhe salla black-box, atelieret e skenografisë, sallat e lëvizjes skenike dhe koreografisë si dhe palestra e fakultetit, Kompletimi me Pajisje & Orendi, Laboratorë Mësimore etj.),*
- *Kërkesat më prioritare, në zërin Investime do të ishin:*
 1. Rikonstruksion i godinës ekzistuese të Fakultetit të Artit Skenik (godina D dhe C. Në godinën C gjendet edhe laborator i “**Salla Black-Box**” i cili përdoret nga studentët e dramës, regjisë, skenografisë, koreografisë dhe regjisë së filmit),
 2. Rikonstruksion i plotë i ‘**Sallës së Madhe të Teatrit dhe Koncerteve**’ (ky është një nga laboratorët më të rëndësishëm për fakultetin e artit skenik dhe atë të muzikës. Më poshtë do ju parashtrojmë një ide më të qartë për këtë sallë)
 3. Kompletim me pajisje & orendi, klasa, studio & atelier e zyra të administratës së fakultetit, **(një kërkesë e vazhdueshme për një situatë aktuale mund të thuhet edhe mjerane me mangësi të theksuara),**
 4. Sistemi i ngrohje ftohjes në ambientet e FAS.
 5. Investime në rrjetin kompjuterik dhe informatik,
 6. Kompletimi i sallës B-Box me infrastrukture mbështetëse për adaptimin në laborator regji & filmi, (dokumenti teknik i gatshëm)
 7. Blerje literature e përditësuar për programet e studimit të FAS në fondin e Bibliotekës.
 8. Investim për laboratorët e programit të studimit Regji Filmi dhe Televizioni.
 9. Investim për realizimin e laboratorit të kostumografisë.
 10. Investim në rregullimin e tarracës të fakultetit.
 11. Investim në sistemin e ndriçimit (për punë) të ambienteve si: studio, klasa, Atelierin e Skenografi-Kostumografi, sallën e Koreografisë, klasat e Regji Filmi dhe Televizioni, Palestra, zyra, koridore.
 12. Investim total në **sallën e madhe Koreografi**

INFORMACION MBI REALIZIMIN E QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE TË MËSIMDHËNIES, TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE VEPRIMTARIVE KRIJUESE DHE INOVACIONIT (sipas udhëzimi nr. 5, datë 19.02.2018):

- a) Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së.

- b) Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.
- c) Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:
 - i) politikat e kërkimit shkencor;
 - ii) të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien;
 - iii) produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësia bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit;
 - iv) të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor.
- d) Të dhëna mbi programet e studimit.
 - i) IAL-ja informon mbi të gjitha programet e studimit që ofron, përfshirë ato ndërdisiplinore dhe të përbashkëta, nëse ka. Në raport paraqiten programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, për të cilën/cilat është marrë leje për hapjen e tij/tyre, por nuk është aktivizuar.
 - ii) IAL-ja informon mbi marrjen e lejes për hapjen e programit të studimit që është në process vlerësimi, si dhe për programe që ofrojnë formim të vazhdueshëm për të tretë apo për zhvillimin profesional të personelit të tyre. Këto të dhëna shoqërohen me numrin dhe datën e aktit për hapjen, për pezullimin ose për mbylljen e programit të studimit.

Mbështetur në këtë pikë, fakulteti ynë propozoi dhe aplikoi për tre programe doktoratë sipas departamenteve:

- a) Aktrim dhe Teori;
- b) Skenografi dhe Koreografi;
- c) Regji dhe Regji Filmi dhe TV.

Programi “Doktoraturës në Arte” synon të zhvillojë aftësitë artistike, të gjenerojë njohuri të reja dhe të avancojë kërkimet në fushën e artit. Ai mundëson që studentët e regjistruar në këtë program të zhvillohen profesionalisht jo vetëm si artistë por edhe si studiues, duke zgjeruar kompetencat artistike dhe aftësitë për të krijuar dhe mësuar njohuri të reja si dhe duke zbatuar metoda artistike innovative në aktivitetin e tyre profesional në fushën e artit.

Fokusi i programit Doktoraturës bazohet tek puna kërkimore shkencore dhe krijuese. Ajo fokusohet dhe ndërton strukturën e saj duke u mbështetur mbi aspektet e hulumtimit dhe analizave të koncepteve krijuese si dhe aspektit artistik të tyre në specifikën e skenografisë, kostumografisë dhe koreografisë. Shtrirja e këtyre projekteve studimore lidhet me problematikat e artit specifik që është shfaqur në shekullin e 20-të, në vendin tonë dhe në botë.

Misioni i këtij programi doktoratë është të formojë studiues me integritet të lartë profesional, kulturor, qytetar dhe promovues të rolit që ka arti skenik në edukimin e shoqërisë shqiptare

Qëllimi i këtij programi doktoratë është të përgatisë studiues me njohuri teorike dhe të aftë për të bërë hulumtime dhe analiza krahasuese në fushën e artit dhe specifikat e studentit.

Programi i doktoratës i përmbahet si parimeve të Salzburgut të vitit 2005, ku u hodhën themelet për diskutimin e edukimit të doktoraturës si pjesë e procesit të Bolonjës, por dhe parimeve të takimit të Salzburgut II të vitit 2010 që identifikoi disa parime për diplomën e ciklit të tretë të studimeve të fokusuar të:

- *programi doktoral si avancim i njohurive përmes hulumtimit fillestar;*
- *përfshirja e programit doktoral në strategjitë dhe politikat institucionale;*
- *rëndësia e diversitetit;*
- *identiteti i kandidatëve të doktoraturës si hulumtues të hershëm;*
- *rol i vendimtar i udhëheqësit shkencor dhe vlerësuesit;*
- *arritja e një mase kritike si një qëllim i rëndësishëm i programeve të doktoratës;*
- *kohëzgjatje e programit studimit prej tri deri në katër vjet;*
- *promovimi i strukturave innovative;*
- *rëndësia e mobilitetit për kërkuesit e doktoraturës;*
- *gjetja financimit për kandidatët e doktoraturës;*

Në këtë kuadër edhe Programi i Doktoratës në Fakultetin e Artit Skenik pranë Universitetit të Arteve duhet të hapet nga nevoja për të drejtuar teorikisht edhe shndërrimin dhe rolin e arteve skenike në një "opsion të dijes", për t'u bërë fokusi i një konteksi kërkimor me orientim ndërkombëtar. Në këtë mënyrë, kushtet e nevojshme për të vetënjohur krijimtarinë artistike, përbëjnë një objekt të hulumtimit bazë, të kombinuar ndërmjet veprimtarive akademike, krijuese e artistike.

Programi Doktoratës në Fakultetin e Artit Skenik, pranë Universitetit të Arteve duhet të hapet për tu kthyer në një program i fokusuar në kërkime shkencore të kombinuara, akademike dhe artistike të specialiteteve skenografi, kostumografi, koreografi, aktrim, regji, regji filmi, menaxhim dhe teori arti, aq të munguara në fushën e studimeve shqiptare.

Këtij serioziteti të institucionit tonë si dhe përkushtimit të anëtarëve të personelit akademik të secilit program studimi ku në të ishin angazhuar të gjitha strukturat e UART me një protokoll model nga ana jonë.

Përgjigja e ardhur shprehte mënyrën e një mungese korrekte nga institucioni epror në marrëdhëniet institucionale. Një email, drejtuar përgjegjësve të departamenteve nga një zyrtar, pa asnjë protokoll dhe pa asnjë etikë komunikimi. Me këtë njoftim me tre argumenta të pamotivuar nga dërguesi përgjigjes mbyllej i gjithë interesimi dhe kërkesat e vazhdueshme tonat për hapjen e shkollës së doktoraturës. Pra, përpara kërkesës së personelit tonë akademik, artistët më në zë në vend, me karrierë kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe me një bagazh mësimdhëniesh si askush del një burokrat dhe të mbyll derën për hapjen e doktoraturës.

Kjo duhet shikuar me shumë seriozitet nga institucioni ynë.

DEPARTAMENTI SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI & KOREOGRAFI

Departamenti SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI DHE KOREOGRAFI, është një ndër tre departamentet e Fakulteti të Artit Skenik, të UART. Gjatë vitit akademik 2019-2020 ka bërë përpjekje serioze për të përmbushur misionin e tij për edukimin artistik dhe profesional të studentëve.

Puna e departamentit është fokusuar përgjatë këtij viti akademik tek rritja e standarteve të mësimdhënies dhe realizimin cilësor të projekteve artistike.

Misioni i Departamentit është realizuar duke përmbushur disa objektiva përgjatë këtij viti akademik. Këto objektiva kanë qenë në shërbim të rritjes së nivelit të mësimdhënies dhe të

rritjes të formimit artistik të studentëve, nëpërmjet përfshirjes së tyre në veprimtaritë artistike të realizuar nga stafi akademik i departamentit .

Objektivi kryesor i Departamentit përgjatë vitit akademik 2019 – 2020 ka qenë shprehja e statusit të departamentit si bërthama më cilësore në përgatitjen e edukimit artistik të studentëve. Ky objektivi është realizuar përgjatë këtij viti shkollor së pari nëpërmjet rritjes së veprimtarisë krijuese dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të studentëve. Ky objektivi është realizuar edhe nëpërmjet implementimit të ndërthurjes së mësimdhënies cilësore me rritjen e aftësive krijuese e artistike të studentëve dhe pedagogëve nëpërmjet aktiviteteve dhe realizimit të projekteve artistike.

Departamenti SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI DHE KOREOGRAFI edhe në vitin shkollor 2019 -2020 është mbështetur në ndjekjen e arritjes së objektivave që departamenti ka iniciuar në fushën e mësimdhënies dhe në veprimtarinë krijuese artistike. Departamenti ka pasur si objektiva kryesorë:

- Rritjen e standarteve të mësimdhënies dhe kualifikimit artistik të studentëve të programit të studimit SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI DHE KOREOGRAFI. Realizimin e trajnimit të mësuesve të fushës së artit në sistemin parauniversitar
- Promovimin e vlerave profesionale të studentëve nëpërmjet aktiviteteve artistike si dhe orientimin e tyre drejt tregut të punës në fushën e punësimit.
- Rritja e aftësisë menaxheriale për orientimin e karrierës së studentëve drejt fushës së specialitetit dhe mësuesisë së fushës së artit.

1. Procesi mësimor në Departamentin SKENOGRAFI-KOREOGRAFI gjatë vitit akademik 2019 - 2020

Departamenti SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI dhe KOREOGRAFI ka realizuar me përgjegjësi procesin mësimor gjatë vitit akademik 2019 – 2020, Ai e ka konsideruar këtë proces si një element bazë të arsimit në arsimin e lartë. Procesi mësimor është realizuar me standarte si në programin e studimeve Bachelor dhe në programin e studimeve Master Aktrim dhe Mësuesi.

Departamenti e ka fokusuar realizimin e procesit mësimor nëpërmjet përdorimit të teknikave bashkëkohore të mësimdhënies si në bllokun e lëndëve profesionale artistike ashtu dhe në bllokun e lëndëve teorike. Programet e studimit në këtë departamentin janë bazuar në rregulloret përkatëse të cilat kanë evidentuar rregulla të qarta në realizimin e programeve. Departamenti ka organizuar planin mësimor të dy programeve të studimit në Bachelor dhe Master të organizuar sipas Udhëzimeve përkatëse të MASR.

Plani mësimor Bachelor në Programin e Studimit SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI dhe Programin e Studimit Koreografi realizohet në tri vite akademike dhe ka 180 kredite. Plani mësimor Master në Programin e Studimit SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI DHE MËSUESI dhe Programin e Studimit Master në Koreografi dhe Mësuesi, realizohet në dy vite akademike dhe ka 120 kredite.

Analiza strukturore e planeve mësimor të programeve të studimit të departamentit është konform kërkesave që kanë udhëzimet e MASR, duke shprehur si orët mësimore në auditor dhe orët mësimore jashtë auditorit. Raporti i tyre është sipas kërkesave të lejuara për hartimin e planit mësimor të programeve të studimit. Është realizuar në vazhdimësi rifreskimi i syllabuseve të lëndëve mësimore duke futur literaturë bashkëkohore dhe duke uniformizuar

paraqitjen grafike të tyre. Departamenti punën përgatitore për rishikimin e syllabuseve e ka realizuar që në fillim të vitit shkollor 2019 – 2020.

Departamenti ka realizuar ndarjen e ngarkesës mësimore për vitin shkollor 2019 – 2020. Ndarja e ngarkesës mësimore është realizuar duke u nisur së pari nga kriteri përvojës profesionale që ka stafi i departamentit në fushën e mësimdhënies dhe së dyti nga kriteri i përgatitjes profesionale të stafit me karakteristikat që kanë kurikulat e programeve të studimit të departamentit.

Ngarkesa mësimore është realizuar sipas Udhëzimit të ardhur nga MASR në muajin shtator 2019 dhe është konform legjislacionit të arsimit të lartë shqiptar. Ndarja e ngarkesës mësimore të departamentit ka parasysh edhe statusin e UART si IAL me status të veçantë në drejtim të organizimit të mësimdhënies.

Gjithashtu procesi ndarjes së ngarkesës ka pasur parasysh edhe mbingarkesën duke mos tejkaluar ngarkesën mbi 200 orë mësimore shtesë në auditor. Gjithashtu ka vazhduar përpjekja për të reduktuar edhe numrin e personelit të ftuar, duke tentuar që Departamenti të mbulojë me staf të brendshëm mbi 90 % të ngarkesës së orëve mësimore të programeve të studimit.

Procesi i përzgjedhjes së pedagogëve të ftuar nga Departamenti për vitin shkollor 2019 – 2020 është realizuar me transparencë të plotë. Ky proces ka përfshirë së pari hapjen e periudhës së aplikimit për ngarkesat mësimore që duheshin për tu mbuluar me pedagogë të ftuar. Procesi përzgjedhjes ka vazhduar pastaj me konkurrimin në departament.

Stafi akademik me kohë të plotë i Departamentit ka bërë përpjekje serioze përgjatë vitit shkollor 2019 – 2020 për të realizuar një proces mësimor me standarte në mësimdhënie. Stafi akademik në lëndët e formimit profesional të studentëve ka shfaqur nivel profesional e didaktik në procesin e mësimdhënies së tyre. Kjo evidentohet nga fidebaku i dhënë nga studentët dhe drejtuesi i departamentit. Stafi ka dëshmuar përpjekjet për të realizuar mësimdhënie cilësore. Është synuar rritja e cilësisë së mësimdhënies në lëndët profesionale artistike, për rritjen e nivelit të formimit artistik të studentëve në programet e studimit të departamentit.

Ky evidentim vihet re në rritjen e efektshmërisë së punës mësimdhënëse të stafit të departamentit nëpërmjet përdorimit të metodologjive efektive të mësimdhënies dhe rritjes së motivimit të stafit akademik e studentëve. Ka vazhduar nga stafi akademik përpjekja për të realizuar një proces mësimdhënie sa më interaktiv dhe promovuar rritjen e aftësive krijuese e artistike të studentëve.

Edhe përgjatë këtij viti shkollor qëndron shqetësimi i vazhdueshëm i departamentit me mbështetjen me bazën materiale dhe didaktike të domosdoshme për realizimin e procesit mësimor. Mos përmbushja e plotë e kërkesave për bazën materiale ka krijuar në disa raste edhe probleme për zhvillimin me standarte të larta të procesit mësimor. Kjo kërkesë e përsëritur për disa vite, ende nuk është realizuar plotësisht. Kjo sidomos në laboratorin e kostumografisë. Në historinë e tij programi i studimit Skenografi-Kostumografi ka marre vetëm dy kompjuter dhe një skaner.

Ristrukturimi i programit Master ka mundësuar që studenti, krahas formimit të tij profesional e artistik, të përgatitet edhe si mësimdhënies në fushën e artit në arsimin para universitar. Departamenti ka punuar me seriozitet për të mundësuar rritjen e formimit didaktik të studentit në programin Master. Programi studimit Master i Arteve ju ka krijuar mundësi studentëve që të orientohen më mirë në tregun e punës duke pasur më shumë mundësi punësimi jo vetëm si

profesionist në fushën e artit skenik por edhe si mësues në fushën e artit në sistemin shkollor parauniversitar.

2. Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe projektet artistike e shkencore

Departamenti ka vazhduar edhe përgjatë vitit shkollor 2019 – 2020 të marri pjesë me stafin e tij akademik në jetën krijuese me krijimtari të mirëfilltë artistike, duke përfshirë edhe studentët e programit Bachelor dhe Master. Stafi akademik i Departamentit me emrat e mirënjohur të jetës artistike ka bërë të mundur shkrirjen e natyrshme të mësimdhënies me procesin e performimit artistik.

3. Aktiviteti artistik e krijues i Departamentit.

Programi i studimit Skenografi-Kostumografi:

Stafi akademik i këtij programi studimi përgjatë këtij viti akademik, në qendër të punës së tij krijuese, ka patur pjesëmarrjen e studentëve në procesin krijues në skenë. Studentët, gjatë këtij viti shkollor, kanë qenë pjesë aktive e projekteve artistike të realizuara në fakultetin tonë si realizimin e skenografive dhe kostumografive.

Pedagogët kanë qenë mjaft aktiv në projektet artistike brenda dhe jashtë vendit, pavarësisht situatës së pandemisë. Ndërsa edhe një pjesë të projekteve nuk u realizuan nëpër salla apo galeri ato u përshtatën dhe u shfaqën me sistemin online, ndër to përmendim:

Orion Shima:

Ekspozita SIDE BY SIDE (me bashkë autor Martin Stommel) në Galerinë Toptani.

HORTUS CONCLUSUS, shkurt 2020.

Taulant Pustina:

Projekti Kostumet e Filarmonisë të Tiranës.

Berina Kokona:

Kostumografi & Skenografi : “XHELATËT” Teatri Kombëtar;

Kostumografi: Filmi Artistik me metrazh të gjatë “GJIROKASTRA”;

Kostumografi: “Ylli pa Emër” Teatri Shkupit.

Illir Martini: Productin Designer i filmit artistik me metrazh të gjatë: “VERA PA KTHIM”, produksion ndërkombëtar.

4. Programi i Studimeve Koreografi:

Departamenti edhe gjatë vitit 2019 – 2020 është angazhuar për realizimin e projekteve artistik si në mënyrë individuale nga pedagogët e departamentit ashtu dhe me produksione me studentët për të realizuar shfaqje në kuadër të diplomave, aktivitet artistike të programuar dhe projekt detyrat semestrale dhe vjetore.

Kozeta Bakii:

Koreografi: E Diela Shqiptare, Tv. Klan; Sofra Tiranase; “ Kënga Magjike” Pallati Kongreseve. “Festojmë së bashku ” Teatri Fier. "Interpretuesi i ri” Jakov Xoxa Fier online RTSH.

Artan Ibërshimi:

Koreograf në premierën e Ansambilit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore Shqiptare në Maqedoninë e Veriut.

Koreograf: Opera Skënderbeu, Teatrin e Operës dhe Baletit të Maqedonisë së Veriut.

Koreograf: Në veprën teatrale "Opera për tre grosh" me teatrin e Tetovës.

Koreograf: " Dialog me të djeshmen, të tashmen dhe të ardhmen" Festivali Ndërkombëtar i Teatrit Skampa".

Koreografë: Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve Popullore Shqiptare në Maqedoninë e Veriut titulluar "Trioja e Zajazit".

Gjergj Pervazi:

Koreografi: "Kërcejmë apo fluturojmë" Qendra Teatrore e Fëmijëve-Shkup. Koreografi: "Alone Together" Albanian Dance Theater. Koreografi teatër: "ELDORADO" Teatri A. Moisiu Durrës. "Tre Veta në Një Varkë" etj.

Roberta Ndokaj:

Java Arbëreshe në Itali, "Larmi Kërcimesh për 8 Marsin", "Dancin in Albania", etj.

5. Konkursset e pranimit

Procesi i organizimit të konkurseve të pranimit të studentëve në programet e Departamentit Skenografi-Kostumografi dhe Koreografi për përgjatë vitit shkollor 2019 – 2020 ka qenë një moment i rëndësishëm në procesin mësimor dhe organizativ të departamentit. Procesi i konkurimit është zhvilluar me transparencë të plotë dhe është monitoruar me shumë vëmendje nga strukturat drejtuese të fakultetit si dhe nga vetë departamenti konform LAL 80/2015 dhe Statutit të UART. Procesi konkurimit ka zbatuar rregullat dhe udhëzimet përkatëse.

Edhe konkursi i zhvilluar për programin Master ishte i suksesshëm. Stafit departamentit organizoi procesin e përzgjedhjes së kandidatëve duke kombinuar aplikimin e tyre me dosje dhe me intervistimin e aplikantëve për të mundësuar zgjedhjen e më të talentuarve.

6. Programet e studimit

Departamenti Skenografi& Kostumografi dhe Koreografi është pjesë e FAS të UART.

Programet e studimit që ka realizuar Departamenti përgjatë vitit shkollor 2019 – 2020 janë:

PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË NË BACHELOR:

1. "SKENOGRAFI DHE KOSTUMOGRAFI"
2. "KOREOGRAFI"

PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË NË MASTER:

1. "SKENOGRAFI DHE KOSTUMOGRAFI DHE MËSUESI"
2. "KOREOGRAFI DHE MËSUESI"

DEPARTAMENTI AKTRIM DHE TEORI:

- 1. Qëllimi dhe objektivat e Departamentit Aktrim & Teori të FAS.**

Gjatë vitit akademik 2019 – 2020, Departamenti Aktrim & Teori, pjesë e Fakulteti të Artit Skenik, të UART. ka përmbushur me cilësi misionin që ka si pjesë e arsimit të lartë shqiptar, për të dhënë një edukim artistik dhe profesional me standarte bashkëkohore për studentët e artit dramatik shqiptar. Veprimtaria e departamentit përgjatë këtij viti shkollor u fokusua te rritja e standarteve të mësimdhënies dhe realizimi cilësor i projekteve artistike në fushën e aktrimit. Misioni i Departamentit Aktrim u realizua duke përmbushur objektivat që ai kishte parashikuar përgjatë këtij viti shkollor. Këto objektiva kanë qenë në shërbim të rritjes së nivelit të mësimdhënies dhe të rritjes të formimit artistik të studentëve të programit Aktrim. Këto objektiva u realizuan nëpërmjet përfshirjes së tyre në veprimtaritë artistike të realizuar nga stafi akademik i departamentit .

Edhe përgjatë vitit shkollor 2019– 2020 objektivi kryesor ka qenë promovimi statusit të departamentit si bërthama më cilësore në përgatitjen e edukimit artistik të studentëve në fushën e aktrimit në Shqipëri. Ky objektivi është realizuar nëpërmjet rritjes së veprimtarisë krijuese dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të studentëve të degës së aktrimit. Gjithashtu komponent tjetër i realizimit të këtij objektivi ka qenë edhe realizimi i tyre nëpërmjet implementimit të ndërthurjes së mësimdhënies cilësore me rritjen e aftësive krijuese e artistike të studentëve dhe pedagogëve nëpërmjet realizimit të projekteve artistike. Realizimi i këtij objektivi ka prodhuar rritjen e nivelit të edukimit të studentëve jo vetëm në rritjen e kualifikimit të tyre profesional, por edhe që të jenë qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë.

Departamenti përgjatë vitit shkollor 2019 -2020 është mbështetur në realizimin e objektivave që ka iniciuar si në fushën e mësimdhënies dhe në fushën e krijimtarisë artistike e shkencore . Objektivat kryesorë që ka realizuar Departamenti kanë qenë :

- Promovimi standarteve të mësimdhënies të studentëve të programit aktrim, diktuar edhe nga kushtet specifike të krijuara nga tërmeti në semestrin e parë dhe pandemia e Covid – 19 në semestrin e dytë
- Ndjekja e trajnimit të mësuesve të fushës së artit në sistemin para universitar
- Evidentimi profesional i studentëve të aktrimit me pjesëmarrjen e tyre në aktivitete artistike
- Orientimi i studentëve ndaj hulumtimit të tregut të punës në fushën e aktrimit.
- Rritja e aftësisë së studentëve për orientimin ndaj karrierës profesionale në fushën e aktrimit dhe mësuesisë .

Arritjet e këtyre objektivave nga Departamenti u realizuan nëpërmjet implementimit të disa strategjive të orientuara drejt :

- Rritjes së numrit të studentëve në programin aktrim nëpërmjet menaxhimit më të mirë të kapaciteteve akademike.
- Përmirësimin e vazhdueshëm të standarteve të mësimdhënies, edhe nëpërmjet aplikimit me nivel të mësimin online
- Pjesëmarrjes aktive të stafit akademik dhe studentëve në projekte artistike dhe shkencore
- Kontributit prezent të stafit akademik në jetën artistike skenike të vendit, duke ju përshtatur kushteve të krijuara nga Covid -19

Veprimtaria e departamentit Aktrim & Teori për realizimin e objektivave në fushën e mësimdhënies dhe të formimit profesional e artistik të studentëve u orientua drejt:

- Rritjes së standarteve të mësimdhënies edhe në mësimin në distancë;
- Vazhdueshmërisë së rritjes profesionale dhe artistike të stafit akademik
- Pjesëmarrjes ë stafit të departamentit në aktivitete artistike kombëtare e ndërkombëtare
- Shtimit të infrastrukturës artistike në shërbim në shërbim të mësimdhënies dhe aktivitetit artistik profesional të stafit dhe studentëve me salla, studio dhe mjete didaktike
- Riorganizimin e programeve të studimit në përshtatje me nevojat e tregut të punës në fushën e artit.

2. Procesi mësimor në Departamentin Aktrim & Teori gjatë viti shkollor 2019 - 2020

Departamenti Aktrim & Teori ka realizuar me përgjegjësi procesin mësimor gjatë vitit akademik 2019 – 2020, Ai e ka konsideruar këtë proces si një element bazë të formimit të studentëve. Departamenti ka bërë përpjekje, ndodhur edhe përpara vështirësive të shkaktuara nga pandemia Covid – 19, për të realizuar me standarte mësimdhënien në programin e studimeve Bachelor Aktrim dhe në programin e studimeve Master Aktrim dhe Mësuesi .

Departamenti e ka fokusuar realizimin e procesit mësimor nëpërmjet përdorimit të teknikave bashkëkohore të mësimdhënies si në bllokun e lëndëve profesionale artistike ashtu dhe në bllokun e lëndëve teorike. Programet e studimit në departamentin Aktrim janë bazuar në rregulloret përkatëse të cilat kanë evidentuar rregulla të qarta në realizimin e programeve. Departamenti ka organizuar planin mësimor të dy programeve të studimit të organizuar sipas Udhëzimeve përkatëse të MASR.

Fokusi i veprimtarisë mësimore në programet e studimit të departamentit ka vazhduar të drejtohet te lëndët profesionale artistike. Këto lëndë kanë përqindje të konsiderueshme si në drejtim të sasisë së orëve mësimore dhe në drejtim të numrit të krediteve, konform kërkesave që kanë udhëzimet përkatëse të MASR.

Plani mësimor Bachelor në Aktrim realizohet në tri vite mësimor dhe ka 180 kredite. Plani mësimor Master Aktrim dhe Mësuesi realizohet në dy vite mësimor dhe ka 120 kredite. Riorganizimi strukturor i planeve mësimor të programeve të studimit të departamentit Aktrim është realizuar conform kërkesave që kanë udhëzimet e MASR, duke evidentuar si orët mësimore në auditor dhe orët mësimore jashtë auditorit. Raporti i tyre është sipas kërkesave të lejuara për hartimin e planit mësimor të programeve të studimit. Ka vazhduar rishikimi syllabuseve të lëndëve mësimore duke tentuar përfshirjen në këto syllabuse të literaturës bashkëkohore. Gjithashtu është uniformizuar edhe paraqitja grafike e tyre conform udhëzimeve të MASR.

Ndarja e ngarkesës mësimore të stafit akademik të departamentit Aktrim është realizuar duke u nisur së pari nga kriteri përvojës profesionale që ka stafi i departamentit në fushën e mësimdhënies dhe së dyti nga kriteri i përgatitjes profesionale të stafit me karakteristikat që kanë kurikulat e programeve të studimit të Departamentit Aktrim. Ngarkesa mësimore është ndarë conform Udhëzimit të ardhur nga MASR në muajin shtator 2019. Ndarja e ngarkesës mësimore të departamentit Aktrim ka mbajtur gjithnjë parasysh edhe statusin e UART si IAL me status të veçantë në drejtim të organizimit të mësimdhënies, duke u pasqyruar në kushtet e departamentit Aktrim edhe te mësimdhënia e individualizuar. Procesi ndarjes së ngarkesës ka pasur parasysh udhëzimin e ngarkesës duke mos tejkaluar ngarkesën mbi 200 orë mësimore shtesë në auditor. Gjithashtu ka përpjekje për të reduktuar edhe numrin e personelit të ftuar,

duke tentuar që Departamenti të mbulojë me staf të brendshëm mbi 70 % të ngarkesës së programeve të studimit.

Procesi i përzgjedhjes së pedagogëve të ftuar nga Departamenti për vitin shkollor 2019 – 2020 është realizuar me transparencë. Ky proces ka përfshirë së pari hapjen e periudhës së aplikimit për ngarkesat mësimore që duheshin për tu mbuluar me pedagogë të ftuar. Procesi përzgjedhjes ka vazhduar pastaj me konkurrimin në departament. Departamenti ka angazhuar në fushën e mësimdhënies figura me përvojë profesionale dhe që kanë një aktivitet në fushën e aktrimit. Procesi rekrutimit të pedagogëve të ftuar është realizuar me përgjegjësi sepse ky proces ndihmon për rritjen cilësore të procesit të mësimdhënies në programet e studimit të Departamentit Aktrim.

Stafi akademik i Departamentit ka bërë përpjekje serioze përgjatë vitit shkollor 2019 – 2020 për të realizuar një proces mësimor me standarte në mësimdhënie. Stafi akademik në lëndët e formimit profesional të studentëve ka shfaqur nivel profesional e didaktik në procesin e mësimdhënies së tyre. Kjo evidentohet nga feedbacku i dhënë nga studentët dhe drejtuesi i departamentit. Stafi ka dëshmuar përpjekjet për të realizuar mësimdhënie cilësore edhe në kushtet e mësimin online përgjatë semestrit të dytë të vitit shkollor 19 – 20. Kjo prirje duket edhe nga analiza e rezultateve akademike të studentëve të departamentit Aktrim. Realizimi me cilësi të mësimdhënies në lëndët profesionale artistike dhe teorike ka ndikuar edhe për rritjen e nivelit të formimit artistik të studentëve në programet e studimit të departamentit. Duhet theksuar edhe fryma konstruktive e bashkëpunimit që ka mbizotëruar mes stafit akademik të departamentit dhe studentëve. Kjo frymë bashkëpunimi ka mundësuar rritje të nivelit të mësimdhënies në lëndët e formimit profesional që janë prezente në kurrikulat e programeve të departamentit Aktrim.

Stafi akademik që mbulon formimin teorik me lëndë të fushës së teorisë së artit ka vazhduar edhe në vitin shkollor 2019 – 2020, përpjekjet për rritjen e nivelit të përmbajtjes së leksioneve. Kjo përpjekje është realizuar nëpërmjet futjes së një një literature bashkëkohore që ndihmon rritjen me njohuri bashkëkohore të studentëve të artit skenik. Standartet cilësore të mësimdhënies në lëndët teorike kërkojnë rritjen e peshës së shfrytëzimit të bibliotekës nga studentët. Më gjithë rritjen e prezencës së bibliotekës, madje edhe bibliotekës online, ende duhet vazhduar përpjekja për të pasuruar më tej brendinë e leksioneve në lëndët teorike. Rritja e vazhdueshme e infrastrukturës dhe mjediseve më të përshtatshme për zhvillimin e orëve mësimore teorike, ngelet gjithnjë përparësi për të ndihmuar një mësimdhënie sa më efektive.

Analiza e të dhënave të evidentuara në programin Bachelor Aktrim mbi procesin mësimor të realizuar përgjatë vitit shkollor 2019 – 2020 tregon se departamenti ka realizuar rifreskimin planeve mësimore të riorganizuar sipas kërkesave që kanë aktet nënligjore në arsimin e lartë shqiptar dhe ka realizuar edhe ndarjen e ngarkesës mësimore sipas udhëzimit të ri të MASR. Ky proces ka qenë transparent si në ndarjen e ngarkesës mësimore me stafin akademik dhe në rekrutimet e pedagogëve të ftuar.

Ky fakt ka ndikuar në rritjen e efektshme risë së punës mësimdhënëse të stafit të departamentit nëpërmjet përdorimit të metodologjive efektive të mësimdhënies edhe në kushtet e përballimit të mësimin në distancë përgjatë semestrit të dytë. Mësimi plotësues dhe konsultativ i zhvilluar në fillim të muajit shtator për të mbushur të gjitha problematikat që mund të kishin studentët përgjatë mësimin online, plotësoi më mirë njohuritë e dhëna studentëve dhe ndihmoi për realizimin e objektivave të departamentit. Stafi akademik, pavarësisht vështirësive të këtij viti shkollor, ka bërë përpjekje për të realizuar një proces mësimdhënie sa më interaktiv dhe promovuar rritjen e aftësive krijuese e artistike të studentëve.

Edhe përgjatë këtij viti shkollor ka qenë i pranishëm kërkesa e vazhdueshme e departamentit për rritjen e mbështetjes me bazë material dhe didaktike të domosdoshme, si mjete të rëndësishme për realizimin e procesit mësimor. Kjo ndihmesë ende nuk është në standartet që kërkon mësimdhënia efektive në fushën e artit.

Procesi i mësimdhënies në programin Master ka pasur si qëllim për ti ndërgjegjësuar studentët për të kuptuar se procesi i formimit në fushën e aktrimit është një proces i gjatë dhe nuk mbaron brenda shkollimit në auditoret e fakultetit. Procesi mësimdhënies në programin Master është fokusuar tek fakti se studenti duhet të kuptojë se formimi i tij si artist i skenës kërkon pjesëmarrjen direkte në konkurrenca e konkurrencione lokale e rajonale, fokus që Departamenti e ka pasur në vëmendje përgjatë këtij viti shkollor .

Programi Master ka mundësuar që studenti, krahas formimit të tij profesional e artistik, të përgatitet edhe si mësimdhënies në fushën e artit në arsimin para universitar. Departamenti ka punuar me seriozitet për të mundësuar rritjen e formimit didaktik të studentit në programin Master. Studentët në programin Master mund të orientohen më mirë në tregun e punës duke pasur më shumë mundësi punësimi jo vetëm si profesionist në fushën e artit skenik por edhe si mësues në fushën e artit në sistemin shkollor para universitar.

3. Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe projektet artistike e shkencore

Departamenti Aktrim & Teori është një institucion i arsimit të lartë që ofron diplomë universitare në fushën e Aktrimit . Departamenti ka vazhduar edhe përgjatë vitit shkollor 2019 – 2020 të marri pjesë me stafin e tij akademik në jetën krijuese me krijimtari të mirëfilltë artistike, duke përfshirë edhe studentët e programit Bachelor dhe Master. Stafit akademik i Departamentit me emrat e mirënjohur të jetës skenike ka bërë të mundur shkrijen e natyrshme të mësimdhënies me procesin e performimit artistik. Por duhet theksuar se ky vit akademik ka sjellë vështirësi në realizimin e bashkëpunimeve sepse pandemia e bëri të pamundur lëvizjen. Por për vetë specifikat, arti i aktrimit kërkon interpretim në grup dhe në skenë, dukuri që pas muajit Mars të vitit 2020 kjo u bë e vështirë për tu realizuar dhe në këto kushte u përdoren performanca të reja duke përdorur teknologjinë.

4. Aktiviteti artistik e krijues i Departamenti Aktrim

Departamenti Aktrim & Teori ka vazhduar edhe përgjatë vitit shkollor 2019 – 2020 që krahas aktiviteteve artistike në nivel kombëtar, të zhvillojë edhe një aktivitet të pasur me projekte artistike të realizuara individualisht apo në grup me studentët. Gjithashtu ka dhe disa aktivitete që janë zhvilluar tërësisht në bashkëpunim me studentët në vite të ndryshme të programeve të studimit. Stafit akademik i Departamentit, ka pasur edhe përgjatë këtij viti shkollor, në qendër të punës së tij krijuese, pjesëmarrjen e studentëve në procesin krijues në skenë ndonëse në kushte tepër specifike pas semestrit të parë. Studentët, gjatë këtij viti shkollor, kanë qenë pjesë e disa aktiviteteve artistike të realizuara në disa skena, duke ju përshtatur kushteve specifike që diktoi pandemia e covid – 19. Ata janë përpjekur për të realizuar një proces krijues cilësor për formimin e aktorit edhe nëpërmjet realizimit të provimeve me karakter artistik.

Aktiviteti artistik dhe didaktik në shërbim të formimit profesional të studentëve dhe evidentimi i vlerave artistike dhe krijuese të stafit akademik të departamentit ka vazhduar të japi kontributin artistik e profesional në skenat më të spikatura shqiptare. Kështu, Profesor P. Malaj ka spikatur në veprimtarinë e tij artistike në filmin artistik me regjisorin B. Bisha. Ndërsa A. Basha ka vazhduar me sukses emisionin kombëtar Portokalli dhe ka vendosur edhe një pjesë teatrale në Teatrin e Prishtinës duke vazhduar bashkëpunimin e suksesshëm me Kosovën. G. Rudi ka performuar me sukses në Teatrin Turbina me pjesë teatrale si dhe ka qenë protagonist në një

film artistik duke kontribuar me lojën e tij teatrale. Pedagogia R. Lule ka drejtuar me sukses si regjisore një pjesë teatrale në Teatrin e Shkupit në Maqedoninë e Veriut, duke treguar vlerat më të mira dhe duke përfaqësuar edhe qenien e saj pedagoge e departamentit aktrim të UART. Aktivitet artistik të spikatur ka shfaqur edhe A. Trebicka me lojën e tij në Teatrin Eksperimental në dramën e Shekspirit Jul Qezari apo në filmin shqiptar si aktor të regjisorit N Ajazi. Ndhimesë në aktivitetin artistik ka shprehur dhe pedagoge E. Andrea, me aktivitetin e saj artistik në dramën Kopshti Qershive me Teatrin e Korçës apo me Alter në teatrin e Prishtinës. Gjithashtu kontribut të spikatur artistik ka dhënë edhe pedagogu G. Gjoka me veprimtarinë e tij në disa skena.

Skematikisht këtë aktivitet mund ta japim me tabelën e mëposhtme

Prof Petrit Malaj	Filmi - Inane - i regjisorit B. Bisha Drama – Vizita e Inspektorit- Teatri Turbina
Prof Ass. Ema Andrea	Projekt Artistik – Lojëra ne oborin e pasëm – Teatër – Kopshti Qershive – Teatri Korçës Tokësorë – Korçë Alter – Prishtine
Dr. Rovena Lule	Regjisore e pjesës teatrale - Galaksja - shkruar nga Haward Barket – Shfaqur Ne Teatrin Kombëtar Shkupit Aktore - Filmi Artistik Ndërkombëtarët
Prof. Alfred Trebicka	Drama – Hedda Gabler - e Ibsenit Teatri Eksperimental Jul Qezari – Shekspir Teatri Eksperimental Film – Portreti pambaruar i Klara Belinit - me Regjizor N.Ajazi.
Prof.Ass. Gëzim Rudi	Drama – Epshe dhe Lakmi – Nga Eugen O.Neill Teatri Turbina Filmi – Ne te Dy – Ne rolin e e Babait
Prof. Altin BASHA	Regjisor i spektaklit javor Portokalli –Top Chanel 2019 Karnavalet e Korçës – Teatri Kombëtar Kosove
Prof. Ermira Gjata	Drama – Mbretëresha e Bukurisë së Linei Lit - Teatri Eksperimental

Gjithashtu edhe stafi i lëndëve teorike ka vazhduar lidhjen e njohurive teorike me artin në fushat specifike të cilat mbulojnë në programet përkatëse të studimit. Aktiviteti i tyre shkencor në funksion të formimit të përgjithshëm të studentit ka konsistuar në dy botime tekste në ndihmë të studentëve, 4 referime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, 2 artikuj në revista jashtë vendit, shkrime ciklesh leksionesh, si dhe në shkrime artikujsh në periodikë në shërbim të fushave të studimit që mbuloohen në kurrikulën e programeve të studimit në FAS.

5. Konkursët e pranimit

Procesi i organizimit të konkurseve të pranimit të studentëve në programet e Departamentit Aktrim & Teori edhe përgjatë vitit shkollor 2019 – 2020 ka vazhduar të jetë një moment i rëndësishëm në procesin mësimor dhe organizativ të departamentit. Gjatë muajit Gusht 2019 është ngritur komisioni i pranimit të studentëve aplikant në programin e studimit aktrim. Procesi i konkurrimit është zhvilluar me transparencë të plotë dhe është monitoruar me shumë

vëmendje nga strukturat drejtuese të fakultetit si dhe nga vetë departamenti konform LAL 80/2015 dhe Statutit të UART. Procesi konkurrimit ka zbatuar rregullat dhe udhëzimet përkatëse. Stafi akademik i Departamentit në bashkëpunim me dekanin prof. Petrit Malaj dhe ka treguar seriozitet profesional për mbarëvajtjen e procesit të konkurseve për të mundësuar seleksionimin e vlerave më të mira të shfaqura nga kandidatët konkurrentë. Komisioni vlerësues është zgjedhur me transparencë dhe mbi bazën e profesionalizmit. Fibeku i marrë nga procesi i konkurrimit tregon se grupi i përzgjedhur i studentëve fitues në programin Aktrim përfaqëson aplikantët më të talentuar. Stafi përzgjedhës përmbushi pritshmërinë sepse u realizua një proces mësimor cilësor dhe me nivel krijues me këtë grup studentësh, pritshmëri që është plotësuar me rezultatet që kanë treguar ata si në programin Bachelor dhe në programin Master. Procesi i suksesshëm i konkursit në programin Aktrim është lehtësuar nga angazhimi i një numri pedagogësh të departamentit për të realizuar një fushatë promovuese me nxënësit maturantë në shkollat e mesme artistike dhe në shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm në Tiranë dhe në disa rrethe të Shqipërisë. Mungesa e ankimeve, klima transparente e njohjes me rezultatet, gatishmëria e stafit akademik për të punuar edhe në ditët e pushimit, etj. janë fidebaku më i mirë që ky proces u realizua me sukses.

Edhe konkursi i zhvilluar për programin Master ishte i suksesshëm. Stafi departamentit organizoi procesin e përzgjedhjes së kandidatëve duke kombinuar aplikimin e tyre me dosje dhe me intervistimin e aplikantëve për të mundësuar zgjedhjen e më të talentuarve.

6. Programet e studimit

Departamenti Aktrim & lëndë Teorike është pjesë e FAS të UART.

Programet e studimit që ka realizuar Departamenti Aktrim & Teori përgjatë vitit shkollor 2019 – 2020 janë:

Cikli Studimit Bachelor	
1	Programi studimi Bachelor “Aktrim”

Cikli Studimit Master	
1	Programi studimit Master Arteve në “Aktrim dhe Mësuesi”

Reformimi programeve të studimit ka qenë gjithnjë prioritet i punës së Departamentit Aktrim & Teori. Edhe përgjatë vitit shkollor 2019 – 2020 objektivat kryesorë në fushën e rishikimit të programeve të studimit ishin :

- Rritja e nivelit profesional dhe literaturës së syllabuseve
- Programe studimi më konkurruese dhe sipas nevojave të tregut të punës
- Ofrimi fleksibilitetit të programeve për tu përshtatur me ndryshimin e kushteve
- Mundësi studentëve për edukimin gjatë gjithë jetës;
- Krijimi raporteve më të drejta mes formimit teorik dhe praktik të studentëve;
- Promovimi programeve për tërheqjen e një numri sa më të madh studentësh;
- Krijimi mundësive për realizimin e një mësimdhënie sa më efektive dhe profesionale.

Departamenti edhe gjatë vitit shkollor 2019 – 2020 ka rishikuar planet mësimore të programeve të studimit si në ciklin Bachelor dhe Master. Ndryshimi në planin mësimor ishte bashkimi i

lëndës Aktrim me lëndën Projekt artistik për ti shërbyer më mirë lidhjes së teorisë me praktikën skenike.

Programet e studimit me ndryshimet e pësuara në kurikulën e tyre kanë synuar të jenë më konkurruese duke siguruar vazhdimësinë e studimeve nga niveli Bachelor në nivelin Master Ky orientim ka ndikuar për një formim më të mirë profesional të studentëve duke rritur mundësitë e tyre për më shumë mobilitete në universitetet e rajonit dhe më gjerë në universitetet evropiane. Pjesëmarrja e stafit akademik në mobilitete në universitete të tjera ka krijuar rritje edhe të eksperiencës menaxhuese në hartimin e kurikulave bashkëkohore

7. Studentët

Objektivat e programeve të studimit të departamentit kanë patur në qendër të vëmendjes, pajisjen dhe zhvillimin e një procesi kreativ me studentët mbi njohuritë krijuese e kërkimore në fushën e aktrimit dhe çka është më e rëndësishmja me realizimin konkret të punëve krijuese në provime e projekte artistike

Një element që ka vazhduar të evidentohet në procesin e mësimdhënies, ka qenë rritja e motivacionit që ka shfaqur stafi akademik për të ndikuar në rritjen e interesimit të studentëve për lëndët speciale, lëndët e formimit profesional si aktor dhe për lëndët teorike që i pajisin me kulturë të përgjithshme në shërbim të profesionit . Rritja e interesit të studentëve për procesin e mësimdhënies në këto lëndë është ndihmuar nga rritja profesionale e procesit të mësimdhënies që ka shfaqur stafi akademik i departamentit përgjatë këtij viti shkollor. Ata duke u përballur me kërkesat gjithnjë në rritje të studentëve për një mësimdhënie sa më efektive e bashkëkohore, kanë nxitur rritjen e motivimit të tyre për të realizuar një proces mësimdhënie sa më bashkëkohor dhe me kërkesat që ka sot formimi aktorit në skenën evropiane Departamenti në bashkëpunim të vazhdueshëm me dekanin prof. Petrit Malaj i është përgjigjur me rigorozitet profesional interesave të studentëve, për përgatitjen e tyre teorike dhe praktike.

Studentët e programeve të studimit Aktrim kanë qenë pjesëmarrës edhe në disa aktivitete artistike duke realizuar disa produksione artistike të përbashkëta mes studentëve të programeve aktrim me studentët e degëve të tjera. si regji, regji filmi, koreografi, etj. duke i kthyer ato në moto të studentëve në proçesin krijues.

Temat e projekteve të Diplomave Master dhe Bachelor përfshinë mjaft vepra të autorëve më të mire të dramaturgjisë botërore. Gjithashtu edhe temat teorike të diplomave të studentëve Master kanë qenë cilësore dhe kanë trajtuar problematika teorike e krahasuese bashkëkohore në fushën e aktrimit. Ky fakt vërehet edhe në vlerësimet e rezultateve të studentëve në këtë komponent të vlerësimit të tyre.

Ka vazhduar edhe gjatë vitit shkollor 2019 – 2020 pjesëmarrja e studentëve të angazhuar në veprimtari artistike që kanë të bëjnë me realizimin e projekteve artistike, përvojë kjo që duhet të rritet më tej me pjesëmarrjen e studentëve sepse është një përvojë që ndihmon në formimin e tyre artistik.

DEPARTAMENTI REGJI DHE REGJI FILMI DHE TELEVISIONI

Nr.	Programi i studimit	Kandidatë nga Kosova	Kandidatë nga Maqedonia	Komuniteti Rom	Komuniteti egjiptian
1.	Fizarmonikë Klasike	2	0	0	0
2.	Flaut	1	0	0	0
3.	Kanto	3	0	0	0
4.	Trombë	0	0	0	1
	Totali	6	0	0	1

Konkurset e Fakultetin e Muzikës sipas udhëzimit Nr. 17, datë 30.07.2019 për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të Ciklit të dytë për vitin akademik 2019-2020.

Sipas Kreut IV/5 të këtij udhëzimi procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë, në programet e ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2019-2020, u zhvilluan në datat 7 – 19 shtator 2018.

Në datat 27 shtator – 02 tetor u kryhen Konkursset e Pranimit për Ciklin e Dytë të Studimeve, sipas Kalendarit të afishuar në ambientet e Fakultetit të Muzikës.

KP për program të dytë studimi, cikli i dytë

Nr.	Programi i studimit	Kuota të miratuara	Listat e aplikantëve	Të regjistruar për KP	Fituesit sipas raundit të parë
1.	Pedagogji Muzikore	10	5	5	5
	Totali	10	5	5	5

Sipas Kreut IV/4 të këtij udhëzimi procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për programet e ciklit të dytë të studimeve “Master profesional” dhe “Master i Shkencave”/”Master i arteve”, për vitin akademik 2019-2020, deri në date 18 tetor 2019.

KP për program të parë studimi, cikli i dytë “Master Shkencor”/”Master i Arteve”

Nr.	Programi i studimit	Kuota të miratuara	Listat e aplikantëve	Të regjistruar për KP	Regjistruar si Fitues
1.	Muzikologji dhe mësuesi	5	1	1	0
2.	Kompozim dhe mësuesi	5	1	1	1
3.	Dirizhim dhe mësuesi	4	4	4	4
4.	Piano dhe mësuesi	9	6	6	1
5.	Violinë dhe mësuesi	8	5	5	5
6.	Violonçel dhe mësuesi	3	1	1	1
7.	Violë dhe mësuesi	4	4	4	4
8.	Kontrabas dhe mësuesi	3	2	2	2
9.	Flaut dhe mësuesi	3	2	2	2
10.	Oboe dhe mësuesi	1	0	0	0
11.	Klarinetë dhe mësuesi	2	0	0	0
12.	Fagot dhe mësuesi	2	2	2	2
13.	Korno dhe mësuesi	1	1	1	1
14.	Trombë dhe mësuesi	2	2	2	2
15.	Trombon dhe mësuesi	1	1	1	1
16.	Kanto dhe mësuesi	14	7	7	7
	Totali	67	39	39	39

KP për program të parë studimi, cikli i dytë “Profesional”

Nr.	Programi i studimit	Kuota të miratuara	Listat e aplikantëve	Të regjistruar për KP	Regjistruar si Fitues
1.	Pedagogji Muzikore	20	20	20	20
2.	Bastubë	0	0	0	0
3.	Kitarë	6	1	1	1
4.	Fizarmonikë Klasike	3	0	0	0
	Totali	29	21	21	21

KP për program të parë studimi, cikli I dytë “Profesional”, nga Trojet

Nr.	Programi I studimit	Kuota të miratuara	Listat e aplikantëve	Të regjistruar për KP	Regjistruar si Fitues
1.	Piano	1	1	1	1
2.	Pedagogji Muzikore	1	1	1	1
	Totali	2	2	2	2

Gjatë vitit akademik 2019-2020 në Fakultetin e Muzikës janë bërë ndërhyrje në piano, kontabas, bastub si dhe në të gjithë instrumentet muzikore të varur nga magazina e UART. Nga laboratorit i veglave muzikore për vitin akademik 2020 janë bërë këto akordime dhe riparime;

- 1) Akordime mbi 150 copë
- 2) Ndërrim tela çeliku 820 copë
- 3) Ndërrim tela basi 92 copë
- 4) Mekanizma 35 copë

- 5) Çekiçë 20 copë
- 6) Sordina 45 copë
- 7) Riparime kapitale 3 copë

Gjatë periudhës së karantinës përgjegjësi i instrumenteve muzikore ka qenë në dispozicion për akordimet e pianove edhe në shtëpi të studentëve dhe stafit akademik, për arsye sepse mësimi është zhvilluar online .

FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA

DEPARTAMENTI I ARTEVE TË APLIKUARA

1 Veprimtaria Mësimore

- 1.1.** Për vitin akademik 2019-2020, procesi mësimor ka nisur më 14 Tetor 2019 dhe ka përfunduar në 2 tetor 2020. Sezoni i provimeve, përgjithësisht, janë zhvilluar në përputhje me strukturën e vitit akademik. Për shkak të situatës së krijuar nga Pandemia, mbas muajit Mars, me urdhër të Ministrit të Arsimit nr. 104, datë 30.4.2020, për “Marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020 nga institucionet e arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e Covid 19”, si dhe të vendimit të Rektoratit të UART me nr. 34 datë 04 Maj 2020, “Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19, në Universitetin e Arteve”, lëndët janë zhvilluar online në platformën Microsoft TEAMS, dhe si rrjedhojë ka pasur vështirësi në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe në raste specifike mosrealizim të ngarkesës mësimore. Për këtë arsye, procesi mësimor është përfunduar me vitin e dytë Bachelor në muajin korrik dhe vitin e tretë Bachelor dhe të parë Master në muajin tetor.
- 1.2.** Me fillimin e vitit akademik 2020-2021, Njësia Bazë Arte të Aplikuara ka realizuar shpërndarjen e ngarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar dhe në vazhdimësi të atij me kohë të pjesshme dhe afat të caktuar. Ngarkesa mësimore për vitin akademik 2020-2021 në Njësinë Bazë Arte të Aplikuara ka rezultuar në një total prej 4860 orësh. Stafi akademik me kohë të plotë ka mbuluar 4200 orë mësimore pra rreth 86 % të totalit të orëve, ndërkohë që ai me kohë të pjesshme rezulton të jetë në shifrën e 660 orëve pra rreth 13%.

Të gjithë pedagogët me kohë të plotë kanë marrë përsipër realizimin e mbinormës mësimore në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 *Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë*. Përsa i përket stafit akademik me kohë të pjesshme, konstatohen raste me tejkalim norme dhe këto shkojnë deri në 50% sipas udhëzimit të sipërpërmendur. Krahasuar me vitin e kaluar, konstatohen diferenca në ngarkesën mësimore si më poshtë vijon:

	2018-19	2019-20	Diferenca
Orë gjithsej	4890	4860	30
Stafi Akademik me Kohë të Plotë	4035	4200	+165
Stafi Akademik me Kohë të Pjesshme	855	660	195

Bazuar në shpalljen e konkurseve për punonjës mësimorë stafi akademik me kohë të plotë u shtua me 3 pedagogë të rinj të kategorisë “Asistent Lektorë”. Si rrjedhojë, përpos rënies së përgjithshme të numrit të orëve mësimore, stafi akademik i pedagogëve me kohë të pjesshme u reduktua. Kësisoj, për vitin akademik 2019-20, pranë Njesisë Bazë Arte të Aplikuara rezultojnë 15 pedagogë me kohë të plotë dhe 6 pedagogë me kohë të pjesshme dhe afat të caktuar. Në vazhdimësi për vitet e ardhshme akademike Njësia Bazë Arte të Aplikuara parashikon plotësimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe një rënie në kontraktimin e atij me kohë të pjesshme sipas ngarkesës mësimore përcaktuar. Përsa i përket angazhimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe afat të caktuar dhe lëndëve, sikurse dhe shtrirjeve të tyre në semestra, nuk parashikohen ndryshime rrënjësore.

Pranë Departamentit Arte të Aplikuara në programet studimore të Pikturës Multimedia, Pikturë Tekstili dhe Pikturë Grafike për vitin akademik 2019-20, në të dy ciklet, ndoqën studimet 96 studentë. Numri i studentëve sipas programeve të studimit dhe cikleve përkatëse në të gjitha programet e studimit të ofruara nga Njësia Bazë Arte të Aplikuara rezulton si më poshtë vijon:

	2016-2017		2017-2018		2018-2019		2019-2020	
	Ba.	Ma.	Ba.	Ma.	Ba.	Ma.	Ba.	Ma.
Multimedia	27	13	30	13	30	14	21	13
Tekstil	31	17	30	16	27	15	28	16
Grafike	31	20	37	15	42	21	39	19
Totali	139		141		149		136	

Bazuar në konsultimet e mbajtura me pedagogët dhe konsultimet e herë pas hershme të regjistrave mësimore, rezulton se objektivat e secilës prej lëndëve, në programet e studimit pranë Njësia Bazë Arte të Aplikuara, janë realizuar në përputhje me parashikimet e Syllabuseve të lëndëve respektive.

- 1.3. Përgjatë vitit akademik 2019-20, janë implementuar ndryshimet e Planeve Mësimore në Ciklin II, në kuadër të të cilave, kurrikula mësimore është pasuruar me lëndë të profilit psiko-pedagogjik për programet e studimit Multimedia, Tekstil dhe Grafike. Këto ndryshime janë aplikuar me synimin e rikthimit të të drejtës për qasje në tregun e punës së profesionit të rregulluar me ligj të Mësuesit për studentët e programeve të sipërpërmendura.

Në lidhje me hapjen e studimeve të Ciklit III që çojnë në fitimin e gradës Doktor, dhe bazuar shkresës Nr. 3708 prot. datë 02.04.2019 të MAS, dhe shkresën e Rektorit të UART Nr. 360/1 Prot. datë 09.04.2019, me tonën Nr. 138 prot. datë 09. 04.2019, pranë Njësia Bazë Arte të Aplikuara u ngrit grupi i punës i cili punoi për plotësimin e dosjes dhe aplikimin në MASH. Gjithsesi, mungesa e bazës ligjore për fitimin e gradës Doktor i Arteve, sipas propozimit të UART, dhe i Statusit të UART, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, ka krijuar vështirësi në hartimin dhe plotësimin e dokumentacionit.

Infrastruktura në Shërbim të Mësimdhënies dhe Kërkimit Artistike-Shkencore

Në vazhdimësi të kërkesave të përvitshme, paraqitur nga Njësia Bazë Arte të Aplikuara, përgjatë vitit akademik 2019-20, është arritur përfundimi procedural dhe në disa raste implementimi, i një pjese të investimeve sipas kërkesave tona. Më konkretisht, në përfundim të investimit në shumën 5 630 304 lekë, falë të cilit është mundësuar blerja e kompjuterëve profesionalë me sistem operativ Windows me sistem operativ OS (Macintosh), është siguruar ambienti në të cilin janë vendosur kompjuterit e sipërpërmendur. Kjo klasë i shtohet ambienteve të Fakultetit të Arteve të Bukura dhe në mënyrë specifike Njësia Bazë Arte të Aplikuara, duke plotësuar pikë së pari nevojën e një laboratorit për lëndët Multimedia, Fotografi, Skulpturë, ndërkohë që është parashikuar të plotësojë edhe veprimtari të tjera mësimore, leksione, seminare dhe praktika, të studentëve të programeve të tjera të studimit në FAB.

Gjithashtu, mbas aprovimit të fondit ka përfunduar procedura e blerjes së bazës materiale për Laboratorin e Tekstilit dhe atij të Grafikës.

Aktivite të realizuara në Njësia Bazë Arte të Aplikuara Master- Class, Leksione të Hapura, Ekspozita dhe Tryeza të rumbullakëta.

Përgjatë vitit akademik 2019-20 Njësia Bazë Arte të Aplikuara ka siguruar organizimin dhe mbarëvajtjen e një numri të konsiderueshëm aktivitetesh. Më konkretisht përgjatë vitit akademik 2019-20 janë zhvilluar:

5 nëntor – 20 nëntor 2019	Ambasada Hungareze, ekspozitë dhe workshop fotografie
16 dhjetor – 24 dhjetor 2019	Iva Seferi, ekspozitë personale Multimedia, kuruar nga Vladimir Myrtezai
6 janar – 16 janar 2020	Blerta Xhomo, personale, kuruar nga Vladimir Myrtezai
22 janar – 4 shkurt 2020	Hasan Nallbani, ekspozitë personale kuruar nga Vladimir Myrtezai dhe Ajola Xoxa
21 shkurt – 12 mars 2020	Greg Rama, personale kuruar nga Ardian Isufi
7 korrik – 14 korrik 2020	Atelieri i Multimedias, kuruar nga V. Myrtezai, Edison Çeraj, Altin Lika e Flor Haxhihyseni

Çështje të Tjera:

Problematika 1. Konstatohet përsëri mungesa e mbështetjes financiare që pedagogët duhet të gëzojnë në funksion të një zhvillimi normal të aktivitetit artistik dhe shkencor. Konkretisht, të gjitha pjesëmarrjet e stafit akademik në konferenca shkencore, aktivitete ekspozitash etj., janë mbuluar me shpenzimet e vetë stafit akademik ose me fonde të siguruar nga këta të fundit nëpërmjet aplikimeve në donatorë të ndryshëm. E njëjta problematikë vërehet edhe për financimin e botimeve të studimeve, përkthimeve të stafit akademik.

Zgjidhja 1. Lidhur me problematikën 1, sugjerojmë që të krijohet mundësia e një fondi të dedikuar për të mbuluar shpenzimet e pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca dhe aktivitete artistike në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Gjithashtu propozojmë që Universiteti i Arteve të sigurojë një fond të mjaftueshëm për botimin e një reviste shkencore e cila mund të publikohet dy herë në vit.

Problematika 2. Gjatë vitit akademik 2019-2020 u provua që dhënia e diplomave gjatë sezonit të vjeshtës nuk ishte shumë efiçente duke krijuar problematika dhe dublime të panevojshme komisionesh.

Zgjidhja 2. Të hiqet mundësia e dhënies së diplomës gjatë procesit të vjeshtës.

DEPARTAMENTI I PIKTURËS

Qëllimi dhe objektivat e veprimtarisë mësimore shkencore e artistike në Departamentin e Pikturës.

Departamenti i Pikturës, për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij gjatë vitit shkollor 2019 - 2020, ka pasur një angazhim tepër profesional në aspektin pedagogjik në shërbim të studentëve si dhe në harmonizim të plotë për kualifikimin e tyre në aktivitetet artistike. Së pari vëmendja kryesore ka qenë tek rritja e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet afrimit të njohurive bashkëkohore në procesin pedagogjik, duke përfshirë dhe realizimin cilësor të projekteve

artistike dhe shkencore në fushën e arteve pamore. Departamenti i Pikturës ka gërshetuar eksperiencën e gjatë pedagogjike të stafit akademik me tendencat më të fundit të artit, duke u bërë lider i prurjeve bashkëkohore që konturojnë qartë jo vetëm realizimin e objektivave për arritjen e misionit tonë, por gjithashtu evidentojnë institucionin si qendra kryesore e arsimit të lartë në fushën e arteve pamore, me prezantime studentore të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me orientim drejt punësimit për tregun e punës.

Departamenti i Pikturës, për vitin akademik 2019 - 2020 në planin e objektivave strategjike, ka ndërthurur planet mësimore me eksperiencat pedagogjike ndërkombëtare që lidhen me programin ERASMUS+, duke sjellë risi informacioni dhe analize për t'u përshtatur më së miri me strukturat e shkollave europiane, në shkëmbimin ndër universitar ndërmjet pedagogëve dhe studentëve.

Fokus i rëndësishëm ka qenë përshtatshmëria e njohurive akademike në funksion të aktivitetit kulturor dhe artistik, që vjen si rezultat i informacioneve të detajuara e të trajtuara nëpërmjet stafit pedagogjik në programet përkatëse të studimit, duke i dhënë fakultetit tonë jo vetëm vlera me rëndësi akademike, por edhe funksionin e një qendre të hapur dialogu dhe komunikimi për edukimin artistik.

Departamenti i Pikturës - DP

Në vitin akademik 2019 – 2020, Departamenti i Pikturës në FAB ka vazhduar punën akademike për zbatimin e programeve të studimit përkatëse. Duke patur parasysh qëllimet dhe objektivat kryesore të këtyre programeve, stafi pedagogjik ka punuar me përkushtim dhe seriozitet.

Pasojat e bllokimit nga pandemia dhe adaptimi i procesit mësimor on-line sigurisht u ndjenë edhe në programet e studimit të Departamentit tonë, por, megjithatë, u bënë përpjekjet maksimale nga stafi akademik që studentëve mos u mbetej asgjë pa plotësuar, nga ngarkesa mësimore dhe laboratorët apo punën praktike. Përgjatë kësaj përudhe pandemike, në përputhje dhe të urdhëresave të Ministrisë së Arsimit, u morën të gjitha masat e nevojshme që procesi mësimor të zhvillohet on-line, në përputhje, me platformën Microsoft Teams. Me gjithë vështirësitë fillestare të akomodimit të platformës në fjalë, tashmë procesi ka hyrë në fazën e plotë dhe po zhvillohet rregullisht. Problematikat e reja të pa njohura më parë, po akomodohen më së miri edhe me ndihmë teknike të ofruar nga IT-ja e vënë në dispozicion nga rektorati për këtë qëllim.

Në këtë vit akademik u thellua kërkimi artistik dhe eksperimentimi akademik, në mbështetje të zhvillimeve dhe risive bashkëkohore të skenës artistike ndërkombëtare. Këtij qëllimi i kanë shërbyer edhe marrëdhëniet dhe eksperiencat e ndryshme me shkolla dhe personalitete jashtë kufijve, vizitat dhe workshopet e organizuara nga dekanati dhe Fakulteti në përgjithësi, por edhe nga Departamenti.

Për vitin akademik 2019 – 2020, Departamenti i Pikturës diplomoi 44 studentë në të dy ciklet e studimit, me një paraqitje të kënaqshme dhe rezultate të mira artistike.

Sa i takon punës në për atelie dhe realizimit të detyrave e projekteve të dhëna, në përgjithësi mund të thuhet se janë realizuar objektivat e paracaktuara në nivel të kënaqshëm, por gjithsesi

edhe këtë vit akademik, disa mangësi në infrastrukturën mbështetëse kanë tendencën të kthehen në mangësi kronike, për të cilat duhen marrë masat e nevojshme që të përmbillen. Të tilla do të ishin:

- mungesa e mjediseve optimale për punën në klasë, në programin e studimit Pikturë Kavaleti, si pasojë e numrit të madh të studentëve për një total prej 34 studentësh në Ciklin e Parë dhe 15 për Ciklin e Dytë;
- cilësia e modeleve, një problem i kahershëm, që ka të bëjë me pagesën e ulët të modeleve;
- mungesa e laboratorit të Pikturës së Kavaletit, e një mjedisi të dytë mësimor, apo suportit teknik dhe material për lëndën e Teknologjisë së Pikturës dhe atë të Imazhit Digjital;

Këto mangësi i kemi evidentuar prej kohësh dhe presim të fillojnë të përmbushen, në shërbim të rritjes së mëtejshme të interesit të studentëve për mësimin dhe cilësisë së mësim dhënies në përgjithësi.

Po kështu, kërkohet një angazhim më këmbëngulës i organeve drejtuese të Fakultetit sa i takon realizimit dhe mbështetjes financiare për praktikën mësimore Brenda vendit, si edhe për vizita të shkurtra mësimore në vendet fqinje.

Si rezultat:

Me gjithë përpjekjet serioze të stafit akademik për realizimin e programeve të studimit, mbetet ende mjaft punë për tu bërë në drejtim të mbështetjes logjistike dhe bazës materiale, në zbatim të detyrimeve dhe kritereve që kërkon Procesi i Bolonjës.

Programet e Studimit

Viti i Bazave të Përgjithshme

Viti i bazave të përgjithshme është vit i detyrueshëm për studentët që sapo hyjnë në Fakultetin e Arteve të Bukura, duke pasuruar njohuritë e tyre fillestare dhe zhvilluar kreativitetin artistik.

Teoria e Ngjyrës

Nëpërmjet “Teorisë së Ngjyrës” student duhet të njohë dhe të asimilojë bazën e gramatikës dhe të sintaksës së ngjyrës. Ky proces trajton shumë nga problemet e ngjyrës që pozohet para njeriut dhe pikturës si në planin praktik e ngushtësisht profesional dhe në atë metodik e intelektual.

Në përmjet njohurive që merr, i krijohet mundësia studentit të mos ta konceptojë ngjyrën si një realitet tërësisht individual, por si një unitet të pa kontestueshëm, që lind nga eksperiencia pedagogjike dhe “zbulimet” artistike, dy tendenca themelore në formimin e personalitetit. Duke marrë këto njohuri, studenti, ekuilibrin objektiv të ngjyrës e modelon me koshencën e një ekuilibër subjektiv dhe hedh hapin e pare në projektimin e vet dhe të laboratorit të tij krijues.

Vëllimi në Hapësirë

Qëllimi i këtij kursi është të familjarizojë studentët me marrëdhënien estetike të vëllimit dhe hapësirës në konceptin 3-dimensional. Ky program ka objektiv themelor që të zhvillojë dhe të rrisë kapacitetin e komunikimit të studentit në përmjet gjuhës artistike (imazhit). Ky program realizohet në përmjet ushtrimeve, detyrave, projekteve dhe bisedave teorike. Bisedat teorike

kanë për qëllim që studentët të përvetësojnë konceptet bazë të kompozimit (elementët e tij, gjuhën vizuale).

Kompozimi dhe Teoria e Ngjyrës

Lënda zhvillohet në vitin e parë dhe merr përsipër të ofrojë njohuritë fillestare mbi mundësitë që ofron kompozimi në procesin krijues (detyra, projekte).

Me anë të leksioneve dhe shembujve nga historia e artit bashkëkohor, i prezantohen studentit mundësitë dhe cilësitë që mbart lënda, si: masa, hapësira, figuracioni, ritmi, dimensionimi.

Qëllimi ynë është që të vendoset një proces komunikimi krijues me studentët, ku lënda shtjellohet hap pas hapi dhe mbështetet mbi propozimet e projektet që ata sjellin. Gjithashtu, lënda synon të nxisë qëndrimet personale mbi etikën dhe estetikën ndaj kompozimit në sipërfaqet e sheshta dhe mbi rolin e imazhit dhe figurës në procesin krijues.

Nudo

Programi i Nudos zhvillohet çdo ditë të javës dhe është i detyruar për të gjithë studentët e kursit të parë. Qëllimi kryesor i tij është kontakti i studentit me natyrën, figurën e njeriut, njohjen dhe interpretimin mbi të. Programi synon të aftësojë studentët me mjetet shprehëse, gjuhën plastike dhe veçanërisht të nxisë qëndrime individuale dhe bashkëkohore të shprehjes në raportin që vendoset midis modelit, studentit e mjeshtërisë.

Programi i studimit Pikturë Kavaleti

Në programin e Pikturës, për Ciklin e Parë të Studimeve Bachelor, objektivi kryesor është formimi i kompetencave artistike dhe profesionale të kualifikuara të studentit, që merr në konsideratë pluralizmin e gjuhës dhe përtëritjen e teknikave dhe respekton e nxit kërkimin e tij vetjak. Vëmendje i kushtohet sa teknikave tradicionale aq edhe gjuhëve të reja të shprehjes artistike.

Puna në atelier bazohet kryesisht në realizimin e projekteve, të cilat bëhen shkak për të dale në analiza, diskutime dhe trajtime teorike më të përgjithshme.

Cikli formues dy-vjeçar MA, konsiderohet i dobishëm për të thelluar njohuritë e fituara në Ciklin e Parë Bachelor dhe për të ndërtuar një marrëdhënie të drejtë e logjike mes disiplinave të ndryshme të artit, me synimin për të përvetësuar lidhjen mes traditave gjuhësore dhe atyre më të reja.

Toleranca krijuese është kusht i domosdoshëm për krijimin e një procesi interaktiv, në shërbim të krijimit të një atmosfere sa më të shëndetshme artistike.

Në përfundim të këtij program dy-vjeçar, student mbron diplomën me një projekt konkret në një nga teknikave trajtuara prej tij gjatë dy viteve, e përzgjedhur nga pedagogët në procesin e punës, duke patur parasysh prirjen individuale të secilit.

Të diplomuarit e këtij program mund të zhvillojnë aktivitetet profesional në fronte të ndryshme, si në krijimtarinë e lirë, ashtu edhe në fusha të ndryshme estetike dhe artistike të komunikimit pamor.

Programi i studimit Pikturë Monumentale

Programi i atelierit të Pikturës Monumentale zhvillohet në dy drejtime bazë, Pikturë Murale dhe Pikturë në Transparencë.

Ky program në nivelin Bachelor ofron njohuri mbi procese artistike, që kanë të bëjnë me integrimin e veprës së artit në arkitekturë, në mjedise të jashtme dhe të brendshme. Po ashtu, konsiston në zhvillimin e proceseve krijuese të studentit, duke e pasuruar gjuhën pamore me mjete e teknika alternative e bashkëkohore të shprehjes artistike.

Programi i nivelit Master është i orientuar në thellimin e studimeve të edukimit artistik, me nivel më të lartë profesional, ku përparësi mbetet kreativiteti i orientuar drejt fenomeneve, risive apo prurjeve artistike bashkëkohore.

Programi zhvillon potenciale profesionale duke evidentuar specifikat individuale të studentëve. Piktura Monumentale bashkëshoqëron zhvillimet socio-ekonomike e urbane në sintezë me arkitekturën, ku larmia e teknikave të aplikimit të këtij arti integrohet si një proces pamor unik e me impakt të spikatur publik. Këto njohuri e bëjnë studentin të angazhuar në sfida e veprimtari konkrete si dhe të aftë e të aksesueshëm në tregun e punës.

DEPARTAMENTI I SKULPTURËS

Departamenti Skulpturë, gjatë vitit 2019 - 2020 është angazhuar për realizimin programit mësimorë. Stafi akademik i Departamentit, ka pasur edhe përgjatë këtij viti shkollor, në qendër të punës së tij pedagogjike dhe krijuese, pjesëmarrjen e studentëve në procesin mësimor. Gjate këtij viti u përballëm me disa kushte specifike.

Tërmeti i datës 26 nëntor 2019 27, 28, 29 dhe 2,3,4,5,6 dhjetor 2019 u ndërpre procesi mësimor.

Pandemia Covid 19. Ne zbatim të udhëzimeve dhe urdhëresave të Ministrisë së Arsimit, procesi mësimor ndërpritet nga data 9 Mars 2020 deri me 29 Mars 2020.

30 Mars 2020 deri më 30 maj 2020 sipas udhëzimit të MASR u zhvillua procesi mësimor në sistemin Online, në të gjitha nivelet e studimit.

1 Qershor 2020 deri me 30 Qershor 2020 sipas udhëzimit të MASR u zhvillua mësimi në atelie për vitin e 3 Bachelor dhe vitin e 2 Master. Në të njëjtën periudhë vazhdoi procesi Online me vitin e 2 Bachelor dhe vitin e 1 Master.

1 Korrik 2020 deri më 30 Gusht 2020 u zhvilluan provimet e fund vitit si dhe procesi i diplomave për vitin e 3 Bachelor dhe vitin e 2 Master.

1 Shtator 2020 deri 30 Shtator 2020 sipas udhëzimit të MASR u zhvillua mësimi në atelie për vitin e 2 Bachelor dhe 1 Master si dhe procesi i provimeve të fund vitit.

Përsëris sipas udhëzimeve të MASR në muajin Gusht u zhvillua konkursi i pranimit të studenteve për vitin akademik 2020-2021.

Ndonëse ky vit solli problematika të shumta e sidomos në mësimin Online, stafi pedagogjik pati angazhim serioz për të kaluar këto vështirësi. Vlen për t'u përmendur këtu puna e përkushtuar e Lek. Arben Bajos, i cili në respektim të udhëzimeve anticovid organizoi dhe një ekspozitë me të gjithë studentët e Departamentit të Skulpturës.

Studentët kanë qenë pjesë aktive e projekteve artistike të FAB. Departamenti i Skulpturës ka dy programe studimi, Skulpturë dhe Skulpturë Qeramike.

Gjatë këtij viti akademik departamenti i skulpturës pati një risi pozitive që është punësimi për herë të parë në programin e studimit skulpturë, të laborantit të punësuar në këtë departament, një kërkesë e kahershme e këtij departamenti si edhe një domosdoshmëri në mbarëvajtjen e procesit studimor.

Puna në departamentin e skulpturës për këtë periudhë u karakterizua nga dallime për sa i përket koncepteve në mësimdhënie, koncepte këto e lidhura me ato të krijimtarisë individuale të stafit mësimdhënës.

Gjatë vitit akademik 2019 – 2020 ka pasur mungesat e bazës materiale dhe të kushteve të mësimdhënies.

Në këtë vit akademik (2019 - 2020) pati rezultate të kënaqshme në punët e studentëve të paraqitura veçanërisht në projektet e realizuara për fundin e vitit.

Programi i studimit Skulpturë

Misioni i këtij programi studimi është që të formojë studentë me dije akademike dhe artistike në lidhje me skulpturën, vëllimin dhe marrëdhënien e veprës artistike me hapësirën ku do të ekspozohet. Ky proces aftësimi arrihet nëpërmjet ushtrimeve, detyrave dhe projekteve, që realizohen në mënyrë individuale nga studentët nën drejtimin e stafit akademik. Ushtrimet dhe detyrat kanë për qëllim të rrisin aftësinë analizuese dhe interpretuese të studentit në marrëdhënie me figurën njerëzore dhe subjekte të tjera. Projektet kanë si qëllim rritjen e kapacitetit krijues dhe punës së pavarur të studentit.

Në Ciklin e Parë të Studimit (Bachelor) i jepet një rëndësi më e madhe rritjes së kapacitetit analizues dhe interpretues të studentit nëpërmjet ushtrimeve dhe detyrave studimore. Studentët njihen me gurët, mermerët, hekurin, drurin e materiale të tjera, teknikat e punimit të tyre si dhe mjetet më efikase që ofron teknologjia e kohës.

Në Ciklin e Dytë të Studimit (Master) i jepet një rëndësi parësore rritjes së kapacitetit krijues, punës së pavarur dhe debatit të hapur të studentëve; perfeksionohet raporti aktiv dhe krijues i tij, i lidhur ngushtë me eksperimentimin dhe specifikat e materialeve.

Njohja dhe përpunimi i materialeve e më pas eksperimentimi me ta, realizohet në laboratorin e skulpturës dhe është pjesë e rëndësishme e procesit të punës së atelierit të skulpturës në të dy ciklet e studimit.

Programi i studimit Skulpturë Qeramikë

Atelieri i Skulpturës Qeramikë ka për mision formimin e artistëve qeramistë në dy drejtime kryesore: Qeramikë Artistike dhe Qeramikë

Industriale (dizajn). Synimi kryesor është krijimi i koncepteve të drejta te studentët për shprehjet plastike në rrafsh/hapësirë nëpërmjet aftësimin të tyre profesional për realizime të pavarura dhe me individualitet krijues.

Procesi në Ciklin e Parë të studimit (Bachelor), shoqërohet me studime plastike dhe projekte, të cilat i orientojnë studentët drejt zhvillimeve bashkëkohore.

Laboratori është vendi ku ekzekutohet dhe eksperimentohet teknikisht pjesa më e madhe e projekteve të qeramikës artistike dhe industriale. Në laborator studentit merr njohuritë bazë mbi materialet, procesin tekniko-teknologjik dhe praktikon punën me allçi, baltë, glazurë, pjekjen, veçoritë dhe mënyrat e përdorimit të materialeve të ndryshme.

Në Ciklin e Dytë (Master) studentët orientohen në bazë të prirjeve individuale dhe hapësirave të tregut të punës në zhvillime të veçanta të qeramikës artistike apo industriale.

Sekretaria Mësimore të dhëna mbi studentët

CIKLI I PARË I STUDIMEVE - BACHELOR 2019-2020

VITI I PARË 2019-2020

Programi i Studimit	Nota mesatare	Kalueshmëria	Nr.stud. te regjistruar	Nr.stud. kalues ne v.II	Studentë të gjitha 10	Studentë mbetës
Pikturë	8.64	96%	55	53	0	2
Skulpturë	8.67	95%	22	21	0	1
TOTALI	8.65	95.50%	77	74	0	3

VITI I DYTË 2019-2020

Departamenti	Programi i Studimit	Nota mesatare	Kalueshmëria	Nr.stud. te regjistruar	Nr.stud. kalues ne v.II	Studentë të gjitha 10	Studentë mbetës
Pikturë	PIKTURË KAVALET	9	100%	12	12	1	0
	PIKTURË MONUMENTALE	7.1	100%	6	6	0	0
Arte të Aplikuara	PIKTURË GRAFIKE	8.4	100%	18	18	0	0
	PIKTURË TEKSTIL&MODË	8.3	100%	11	11	0	0
	PIKTURË MULTIMEDIA	9.1	100%	9	9	1	0
Skulpturë	SKULPTURË	8.6	100%	5	5	0	0
	SK.QERAMIKË	7.7	87%	8	7	0	1
TOTALI		8.3	98%	69	68	2	1

VITI I TRETË 2019-2020

Departamenti	Programi i Studimit	Nota mesatare	Kalueshmëria	DIPLOMA			Studentë të gjitha 10	Studentë mbetës
				Nr. studente të diplomuar	Nota mesatare	Kalueshmëria		
Pikturë	PIKTURË KAVALET	8.4	100%	22	8.7	95%	0	0
	PIKTURË MONUMENTALE	8.3	100%	8	9.1	100%	0	0
Arte të Aplikuara	PIKTURË GRAFIKE	8.4	95%	17	9	94%	0	1
	PIKTURË TEKSTIL&MODË	8.4	94%	15	9	94%	0	1
	PIKTURË MULTIMEDIA	8.3	91%	10	8.9	91%	1	1
Skulpturë	SKULPTURË	8.4	100%	6	10	100%	0	0
	SK.QERAMIKË	8.4	100%	6	10	100%	0	0
TOTALI		8.37	97%	84	9.2	96%	1	3

CIKLI I DYTË I STUDIMEVE -MASTER NË ARTE DHE MËSUESI-2019-2020

VITI I PARË 2019-2020

Departamenti	Programi i Studimit	Nota mesatare	Kalueshmëria	Nr.stud. te regjistruar	Nr.stud. kalues ne v.II	Studentë të gjitha 10	Studentë mbetës
Pikturë	PIKTURË KVALET	8.9	88%	9	8	0	1
	PIKTURË MONUMENTALE	8.4	100%	5	5	0	0
Arte të Aplikuara	PIKTURË GRAFIKE	8.8	100%	9	9	0	0
	PIKTURË TEKSTIL&MODË	8.8	100%	9	9	0	0
	PIKTURË MULTIMEDIA	8.8	100%	9	9	1	0
Skulpturë	SKULPTURË	9.1	100%	5	5	0	0
	SK.QERAMIKË	8.9	50%	2	1	0	1
TOTALI		8.8	91%	48	46	1	2

VITI I DYTË 2019-2020

Departamenti	Programi i Studimit	Nota mesatare	Kalueshmëria	DIPLOMA			Studentë të gjitha 10	Studentë mbetës
				Nr. studente të diplomuar	Nota mesatare	Kalueshmëria		
Pikturë	PIKTURË KVALET	8.8	100%	6	9.2	100%	0	0
	PIKTURË MONUMENTALE	8.8	100%	4	10	100%	0	0
Arte të Aplikuara	PIKTURË GRAFIKE	8.9	100%	11	10	100%	1	0
	PIKTURË TEKSTIL&MODË	8.7	100%	7	9.7	100%	0	0
	PIKTURË MULTIMEDIA	8.8	100%	5	9.8	100%	1	0
Skulpturë	SKULPTURË	8.8	100%	3	10	100%	1	0
	SK.QERAMIKË	7.6	100%	1	9	100%	0	0
TOTALI		8.6	100%	37	9.67	100%	3	0

Për vitin akademik 2019-2020 për të dy programet e studimit janë regjistruar studentë si më poshtë:

CIKLI I PARË I STUDIMEVE - BACHELOR 2019-2020

KONKURS 2019-2020

Programi I Studimit	Kuota të miratuara	Kandidatë të regjistruar	Fitues në 2 Raunde	Troje	Aftësi e Kufizuar	Transferim
Pikturë	70	101	50	2	2	1
Skulpturë	40	31	20	0	0	0
TOTALI	110	132	70	2	2	1

CIKLI I DYTË I STUDIMEVE -MASTER NË ARTE 2019-2020

KONKURS 2019-2020

Programi i Studimit	Kuota të miratuara	Kandidatë të regjistruar	Fitues	Troje	Program i Dytë	Transferim
PIKTURË KAVALET DHE MËSUESI	8	10	8	1	0	0
PIKTURË MONUMENTALE DHE MËSUESI	8	7	6	0	0	0
PIKTURË GRAFIKE DHE MËSUESI	8	12	8	0	1	0
PIKTURË TEKSTIL&MODË DHE MËSUESI	8	13	8	1	0	0
PIKTURË MULTIMEDIA DHE MËSUESI	8	11	8	0	1	0
SKULPTURË DHE MËSUESI	6	5	5	0	0	0
SK.QERAMIKË DHE MËSUESI	6	2	2	0	0	0
TOTALI	52	60	45	2	2	0

Për vitin akademik 2020-2021 për të dy programet e studimit janë regjistruar studentë si më poshtë:

"Bachelor" për vitin akademik 2020-21
 50 pikturë + 3 me aftësi të kufizuar
 20 skulpturë + 1 Rom

Gjithsej 74 studentë

"Master në Arte " VITI AKADEMIK 2020-21

Pikturë Grafike dhe Mësuesi 13
 Pikturë Kavalet dhe Mësuesi 10
 Pikturë Multimedia dhe Mësuesi 8+ 1 Program i Dytë studimi
 Pikturë Tekstil dhe Modë dhe Mësuesi 8 + 3 Troje
 Pikturë Monumentale dhe Mësuesi 6
 Skulpturë dhe Mësuesi 2
 Skulpturë Qeramikë dhe Mësuesi 5

GJITHSEJ 56 studentë

Në bashkëpunim dhe me strukturat e tjera drejtuese në UART këtë vit akademik është bërë e mundur rregullimi ose kompletimi i laboratorëve si më poshtë:

Laboratori i ri i multimedias

Për zhvillim e një procesi sa me korrekt dhe te përshtatshëm për lendet e këtij atelieri u arrit kompletimi i laboratorit nga ana vizuale dhe me pajisje të teknologjisë të fundit:

1. kompjuter, printer, video-projektor dhe pajisje te tjera
2. kamera dhe objektiv atelieri videos

Rikonstruksion ne laboratorin e qeramikës

1. rikonstruksioni i furrës se madhe,
2. rikonstruksioni i kompresorit
3. blerje e termoçiftit,
4. rikonstruksion i motorit te tornos

Laboratori monumentales

1. xham katedralesh, boje afresku

BIBLIOTEKA SHKENCORE UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Për te treguar arritjet dhe rolin e bibliotekës e cila me shërbimet, koleksionet dhe hapësirat e saj po luan një rol te rëndësishëm ne komunikimin universitar nëpërmjet këtyre shërbimeve, politikave dhe kujdesit ne mbështetje te evolimit te këtij komunikimit/te procesit mësimore dhe te punës artistike dhe ruajtja e trashëgimisë te mësuarit gjate gjithë jetës si dhe me kryesorja mbështetja e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Biblioteka e Universiteti Arteve për të përmbushur misionin e saj si mbështetëse e procesit mësimore dhe te funksionojë si qendër arti ne gjithë vendin, ka punuar ne baza të një strategjie të caktuar për shërbimet, pasurimin e koleksioneve te saj dhe vazhdimësinë ne krijimin e rekordeve bibliografike on line dhe te arkives digjitale si dhe ne ngritjen profesionale te punonjësve të kësaj biblioteke ne vazhdimësi.



Arritjet kryesore:

- Shërbimet e reja në bibliotekë

Implementimi i teknologjisë se re, modulit te qarkullimit (sistemi i integruar “KOHA”) - kartelat elektronike.

Viti i pare akademik kur studente kanë përveç kartelës manuale kane edhe kartelet elektronike. Shërbimi i përdorueseve për këtë vit te ri Akademik nëpërmjet kartelave manuale dhe elektronike ,do te rris efikasitetin ne qarkullimin e materialeve bibliotekare.

Studenti ka kartel elektronike dhe manuale. 793 kartela te reja ne vitin akademik 2019-2020 edhe ne formatin manual edhe ne formatin elektronike.



Ky shërbim i ri ndihmon në rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të shërbimeve në bibliotekë.

Shërbimet që ofron biblioteka për përdoruesit e saj

Shërbimi në Bibliotekën e Universitetit të Arteve gjatë 2020 është bërë nëpërmjet:

Fondit të mbyllur

Ky shërbim është kryer i shpejt dhe cilësor për të tria fakultetet por kryesisht për Fakultetin e Muzikës dhe Artit Skenik pas librat e arteve pamore shërben në fondin e hapur. Është kryer kryesisht në distance. Materialet për procesin mësimorë baze janë skanuar dhe janë dërguar

elektronikisht. Gjithashtu dhe materialet për diplomat janë skanuar. Të gjitha materialet për diplomat e regjisë se teatrit. Shërbimi mbështetës për doktorantët.

Kemi hedhur në katalogut elektronik në Sistemin e Integruar Open Source “Koha”, hyrjet e vitit 2020 dhe librat e fondit të hapur gjithsej 223 libra hyrje te reja.


Shërbimi referues

Mbështetja me informacion të ish studenteve të Universitetit tonë.

Mbështesim punën kërkimore - shkencore duke ndihmuar doktorantët në grumbullimin e informacionit dhe ofrimin e këtij informacionit në mënyrë elektronike (nëpërmjet skanimit dhe dërgimit online). Doktorantët Artan Ibërshimi dhe Denis Bizhga etj.


Disponojmë rreth **23984** rekorde bibliografike në katalogun online

<http://www.uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=344&niveli=75>



- Statistika mbi aksesimin në këtë Katalogun On line nga shumë vende të botës.

Klikimet nga 1 Janari – Dhjetor 2020 (bashkëngjitur statistika e gooli-it)



Janë hedhur ne sistemin Koha te gjithë hyrjet e librave gjate vitit 2020


Shkarkime online te programeve muzikore për klasat e muzikës se dhomës, kantos dhe muzikës instrumentale.

Përdorues ne dite mesatarisht me statistike 80 , niveli me i larta i përdorueseve 100 ne dite

Fondi Audio


Statistika për përdorimin e kompjuterëve (disponojnë programe specifike sipas degëve të artit) të sallës multimediale nga përdoruesit e bibliotekës për nevojat e tyre mësimore dhe artistike.

Krijimi i arkives mësimore digjitale



Krijimi i bazës së të dhënave me rekorde të muzikës shqiptare dhe botërore si dhe të fondeve speciale të Arkivës Mësimore Digjitale si tema diplomash në vite, artikuj studimor dhe materiale promocionale etj.

- Statistika mbi aksesimin ne këtë Arkive Mësimore Digjitale nga shume vende te botes. Disponojmë rekorde në audio dhe tekst të plotë në Arkivën Digjitale



Fondit te hapur ofron koleksionet e arteve pamore, materialet referenciale për të tria fakultetet, kompjuter dhe fotokopje. Fondi i hapur i librave i jep mundësinë përdorueseve te bibliotekës te shfrytëzojnë pa limit librin qe dëshiron dhe duke fotokopjuar faqet qe ju intereson. Vendosja e 5 kompjuterëve (kane akses ne internet, janë instaluar programet specifike te te gjitha degëve te artit) te rinj te mbështetur nga Projekti i UNILAB-it ka bere qe kjo salle shfrytëzohet ne maksimum nga përdoruesit e saj.

- **Zhvillimi i koleksioneve**

Misioni i bibliotekës ne vazhdimësi i BSHUA është te shpërndaj burimet dhe shërbimet për te mbështetur procesin mësimor, mësimdhënien dhe kërkimin ne UART. Biblioteka është vendi ku takohen studentet, qendra e teknologjisë se UART, vendi qe siguron diversitetin e larmishëm te te mësuarit dhe hapësirat e studimit.

1. Rritja e koleksioneve të printuara në bibliotekë gjatë 2020

Pasurimi me koleksion të printuar

- **Pasurimi**

Nga donacionet dhe dhurata nga autoret 223 libra dhe 71 tituj ne shqip dhe ne gjuhe te huaja, arti vizual dhe parte muzikore.

Pasurimi gjate vitit 2020 është arritur:- Nëpërmjet: huazimeve ndër – bibliotekare, dhurata nga individë, donacione të ndryshëm, shkarkime nga interneti dhe portaleve te ndryshme qe lejojnë shkarkimin.

Zhvillimi i koleksioneve ne BSHUA vazhdon fokusimin mbi burimet dixhitale një format i preferuar nga përdoruesit tanë i mundshëm kudo dhe kurdoherë qe atyre ju nevojitet.

Koleksionet dixhitale dhe katalogu online janë zemra e koleksioneve tona. Lehtësia ne aksesim dhe ne kërkim nga çdokush dhe ne çdo kohe, studentet dhe pedagoget shprehin vlerësimin e tyre me mundësin qe kane përfituar dhe nevojat për zhvillimin e tyre ne te ardhmen.

- **Dixhitalizimi i dorëshkrimeve te kompozitoreve shqiptare**

Dosjet e veprave te kompozitoreve si:
Krijimi i rekordeve ne sistemin “Dspace” - te Muzikës botërore

- Arkiva audio:

Rritja e arkives audio

Shkarkimet nga IMSLP i muzikes klasike

Katalogu online - Hedhja e koleksioneve:

Përpunimi i koleksioneve sipas standarteve ndërkombëtare. Çdo rekord bibliografik është i plotësuar me terma për kërkim te zgjeruar dhe specifik.

Koleksionet e hedhura ne katalogun online janë riklasifikuar KDU & Klasifikimi lëndor; verifikuar; rietiketuuar etj.


Fokusi i BSHUA është tek burimet dixhitale ISMLP: Shkarkime nga kjo arkive dixhitale ne formatin PDF

- **Marketingu i bibliotekës**

- Përdoruesit mund të marrin informacion nëpërmjet sitit web të bibliotekës

Studente shqiptare qe studiojnë jashtë Itali, Austri, Amerike, Gjermani etj. mbështetje me literature duke ja dërguar online për tezat e tyre master dhe doktoratë.

BSHUA në rrjetet sociale



Dy sistemet e Bibliotekës Shkencore të UART, Katalogu on line dhe Arkiva Mësimore Digjitale i ofron bibliotekarëve mundësi për të inkurajuar dhe ndihmuar përdoruesit në aftësimin tyre në informacionin me mediumet e reja të të mësuarit.

Përdoruesit janë orientuar në përdorimin e teknologjive të reja në bibliotekë, si të kuptojnë të drejtat e autorit dhe të luftojnë plagjiaturën, si të tërheqin dhe të sintetizojnë përmbajtjen digjitale, dhe si ti përdorin ato për të krijuar materialin e tyre.




uart.edu.al/katalog_biblio

arkiv.uart.edu.al




Facebook

BIBLIOTEKA SHKENCORE UART



- WEB i bibliotekës

Komunikim me perdoruesit



Biblioteka e UART si një biblioteke unikale, speciale, implementuese nga të parat biblioteka në Shqipëri të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Biblioteka e UA ka implementuar sisteme jo komerciale me kode të hapura për përdoruesit e saj për menaxhimin, për ti ruajtur dhe për ti ofruar këto koleksione ne distance përdoruese vetë saj kudo qe ata janë. Ka filluar procesin e dixhitalizimit te koleksioneve te saj prej vitit 2010.

Pengesat/ Sfidat

- Pandemia Covid 19
- Mungesa e skanerit te teknologjive te fundit A3
- Mungese fondesh për abonimet e Aleksander Street Press
- Aftësimi ne informacion
- Huazimi ndër bibliotekar

Aftësimi për studentet e muzikologjisë/doktorantët

Qëllimet për 2021

- Përfundimi i të gjitha koleksioneve në katalogun online – literatura ruse dhe periodiku retrospektiv ruse
- Rritja e rekordeve në arkiven dixhitale
- Implementimi i modulit të qarkullimit - krijimi i kartelave elektronike

Debitorët

Stafi i bibliotekës bëne një punë sistematike për kthimin e materialeve bibliotekare në fondin e saj. Ndjekja e debitorëve aktual dhe në vite. Janë kthyer pjesa më e madhe e materialeve të studenteve që janë në vazhdimësi. Në ndihmë të rektoratit dhe të fakulteteve është bërë:

Pikat e forta:

Futje e teknologjive të reja të informacionit si:

- Automatizimi i krijimit të katalogut online “Koha” dhe moduli i qarkullimit.
- www/universitetiarteve.com/biblioteka/katalogu online
- Krijimi i arkives mësimore digjitale
- Aftësimi në informacion të përdoruesve.
- Duke u udhëhequr nga moto se asnjë përdorues i bibliotekës të mos dali pa një informacion ose orientim rreth materialeve të kërkuar
- Ngritja profesionale e punonjësve të BSHUA

Profesioni i bibliotekareve, si punonjës që merren me dhënie dhe përpunim informacioni dhe sidomos tani në këtë shoqëri të informacionit ku jetojmë, kërkon ngritjen profesionale të tyre në vazhdimësi

Gjatë vitit 2020 kualifikim i mëtejshëm i stafit të bibliotekës dhe i përdoruesve të saj.

Një nga bibliotekaret po ndjek - “Shkollën Kombëtare të Bibliotekëkonomisë”.

- Prezantim me studentet e Muzikologjisë “Aftësimi në Informacion në BSHUA”



Burimet Elektronike te tjera

Portale pa pagese ku mund të gjejmë parte muzikore.



Pikat e dobëta:

- Pandemia covid 19. Kriza ekonomike globale, uljen e donacioneve dhe mos blerje te librave nga Universiteti për këtë biblioteke për disa vjet. Fondacionet dhe ambasadat për shkak të krizës mbështesin shtresat e marginali zura. Mungesa e mjeteve te punës etj. Mungesa ne abonimet online, burimet elektronike.
- Mungesa e një skaneri specifik portabel për skanimin e dorëshkrimeve te vjetra të dëmtuara që të rritet numri i materialeve të digjitalizuara.
- Nevoja për kompjuter te rinj
- Mos gjetja e fondeve nëpër fondacione të ndryshme e një projekti shtesë për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemeve te bibliotekës.
- Probleme me serverin e Arkives Dixhitale
- **Projektet strategjike te bibliotekës në të ardhmen**
- Aplikim ne Agjencinë se Kërkimit Shkencor për notizimine dorëshkrimeve me projektin: Projekt-ide për notizimi i dorëshkrimeve të kompozitoreve shqiptare para viteve 90

Objektivat për te vitin 2020

- Hedhjet e reja dhe fondin ruse ne katalogun online i gjithë fondit te printuar me sistemin e integruar “KOHA” për fondet retrospektive si dhe krijimi i rekordeve për arkiven mësimore digjitale për materialin audio bruto.
 - Projekte për mbështetjen në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemeve në bibliotekë. Pajisje shtesë për dy sistemet ekzistuese të bibliotekës të automatizimit dhe digjitalizimit. Domosdoshmëria e një skaneri për digjitalizimin e dorëshkrimeve dhe pajisjeve të tjera plotësuese si dhe ruajtja e ambienteve me sistem survejimi.
 - Projekt-ide mbi riorganizmin e shërbimit me fond të mbyllur në fond të hapur për përdoruesit dhe implementimin e teknologjive të reja në këtë ambient. Riorganizmi i shërbimit me fond të mbyllur në fond të hapur
 - Projekt për abonimin në burime elektronike.
- Abonim ne baza të dhënash elektronike si Jstor, Aleksander Street Press që janë shumë të domosdoshme për procesin mësimor dhe të kërkua në mënyrë të vazhdueshme nga përdoruesit tanë.
- Projekt për notizimi i dorëshkrimeve të kompozitoreve shqiptare para viteve 90 ne Agjencinë e Kërkimit Shkencore.

VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Veprimtaria e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për vitin kalendarik 2020, si një nga sektorët më të rëndësishme të Universitetit të Arteve, mban volumin kryesor të punës në institucion. Ky volum pune shtrihet në tërë vitin kalendarik 2020 e vijim.

Në zbatim të Ligjit “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimit Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar me akte ligjore, Ligjit të Kuvendit të Shqipërisë “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr., 9367, datë 07/04/2005 “Për parandalimin dhe Konfliktin e Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, Ligjit 119/2004 “Për të Drejtën e Informimit”, Ligjit 9887, datë 10/03/2008 i ndryshuar me ligjin 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore të eprorëve tanë, të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në bashkëpunim të ngushtë me Rektoren e UART, Administratorin e institucionit, me Sektorët e tjerë respektivë që ka lidhje të pashmangshme pune, gjatë vitit kalendarik 2020, duke zbatuar me korrektësi Plan-Programin Vjetor të Punës për vitin 2020.

- o Fillimi i vitit të ri kalendarik 2020, filloi me procedurat për punësim punonjësi mësimorë administrativ dhe vijon gjatë vitit sipas tabelës së më poshtme;

Nr.	Muaji	Fakulteti/ Rektorati	Pozicioni	Lënda /Pr Studimit
1.	Janar	Arteve të Bukura (1 punonjës)	As. Lektor	Pikturë
2.	Janar	Arteve të Bukura (1 punonjës)	Dr. Shkencash	Metodologji mësimdhënie
3.	Janar	Administratë (1 punonjës)	Laborant	Arteve të Bukura
4.	Shkurt	Administratë (2 punonjës)	Përgjegjëse Sektori	Rektorat
5.	Shtator	Muzikës (2 punonjës)	As. Lektor	Piano
6.	Shtator	Muzikës (3 Punonjës)	As. Lektor	Kanto
7.	Shtator	Muzikës (2 punonjës)	As. Lektor	KMDP
8.	Shtator	Administratë (1 punonjës)	Specialiste	Rektorat
9.	Tetor	Administratë (1 punonjës)	Kr/Sekretare	FAS
10.	Nëntor	Administratë (1 punonjës)	Specialiste	Rektorat

- o Më pas, vazhdon si çdo vit të ri kalendarik, vijoi me rifreskimin e kontratave të punonjësve mësimorë me kontratë 1 – vjeçare / punonjësve me Kontratë të Përkohshme (lektorë të ftuar) dhe punonjës të administratës për nevoja të ndryshme të institucionit tonë konkretisht, punëtoreshërbimi (shërbime të cilat nuk mund të kryhen nga punonjësit tanë të shërbimeve) etj.
- o Në zbatim të Ligjit 8889, datë 25. 04. 2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11/05/1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shkresës së MAS, VKM si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore përgatiti materialin për personelin mësimorë dhe jo mësimorë që janë në prag të pensionit/ ose kanë mbushur moshën e daljes në Pension Pleqërie. Pas paraqitjes së materialit tek Rektori për njoftim, së bashku me vendimin për daljen në Pension Pleqërie, të personelit që plotëson kriteret, konsultohet me Rektoren, nëse është dakort për daljen e tyre në Pension.

Drejtorja e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore I/P-A, me në krye Rektoren e Universitetit në zbatim të Ligjit “Për Sigurimet Shoqërore në RSH”, në bashkëpunim të ngushtë me Sektorin Juridik, përgatiti materialet për procedurën për pension pleqërie, të punonjësve mësimorë dhe administratë, të cilët plotësojnë kriteret për Pension Pleqërie, proces i cili zgjat deri në fund të vitit kalendarik 2020, gjatë këtij viti kanë dalë në pension Pleqërie 5 (pesë) punonjës mësimorë në Fakultetin e Muzikës dhe 3 (tre) punonjës të administratës.

SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Angazhimi i Sektorit të Teknologjisë së Informacionit përbëhet nga vënia në një rrafsh e vizionit të zhvillimeve teknologjike me strategjitë Institucionale, duke kryer integrimin e proceseve me teknologjitë përkatëse. Sektori i Teknologjisë së Informacionit është gjithashtu përgjegjës për të gjitha aspektet e zhvillimit dhe implementimit të iniciativave me bazë teknologjike brenda Institucionit. Ky Sektor administron sistemet ekzistuese, njëkohësisht duke i dhënë zgjidhje të gjitha problematikave të lindura në mbështetje të proceseve të Teknologjisë së Informacionit dhe vlerave bazë të Institucionit.

Gjatë vitit akademik 2019-2020, një vit i vështirë dhe sfidues si në aspektin profesional ashtu edhe në atë personal e familjar për gjithsecilin prej nesh, për shkak të fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19 e cila u shtri për mbi 9 muaj, janë synuar të përmbushen të gjitha detyrimet dhe angazhimet me shumë përkushtim dhe pasion.

Sa i takon vetë-vlerësimin të punës për Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, përmes kryerjes së kësaj rezymeje vjetore, gjykojmë se janë tejkaluar pritshmëritë, edhe përballë vështirësive të shumë-fishta të krijuara, duke marrë përsipër dhe duke zbatuar të gjitha angazhimet standarde, ashtu si edhe ato të reja e specifike, me një nivel të përkryer përkushtimi në planin profesional dhe në atë ndër-personal midis kolegëve të TI.

Administrimi i rrjetit kompjuterik të Institucionit me të gjitha elementet përbërëse të tij në tërësi në nivelin harduer dhe softuer, që përfshin administrimin e nyjës kryesore dhe njësive në përbërje të saj, ashtu si edhe të njësive sekondare e terciare të ndërlidhjes fizike dhe me valë, nëpërmjet proceseve të adresimit dhe kontrollit të regjistrimit të adresave elektronike, menaxhimit të sigurisë në hyrje të rrjetit të brendshëm, konfigurimeve dhe kontrollit në distance të njësive përbërëse të zinxhirit të komunikimit, monitorimit të vazhduar të cilësisë së shërbimit, mbajtjes së kopjeve rezervë të konfigurimeve, diagnostifikimit të defekteve, zëvendësimit dhe konfigurimit të pajisjeve të reja, etj., ashtu si edhe shtrimin, riparimit apo zëvendësimit të linjave fizike të ndërlidhjes në rrjetin institucional;

Administrimi i çdo stacioni pune (kompjuterik) të institucionit për personelin administrativ, stafin akademik, stafin ndihmës-akademik, sallat dhe laboratorët mësimorë, stacionet e punës në sallat dhe ambientet e performancave, etj., që përfshin instalim të njësive kompjuterike fizikisht, diagnostifikim dhe riparim të defekteve teknike, zëvendësim, instalim dhe konfigurim të elementeve harduer, ashtu si edhe instalime dhe konfigurime në nivel softuer duke përfshirë instalime të sistemeve operative, paketave softuer apo programeve kompjuterike specifike, konfigurime të përgjithshme apo specifike, konfigurime në rrjetin institucional, etj. Angazhimi njëkohësisht përfshin asistimin kundrejt personelit të Institucionit në procese të punës lidhur me përdorimin e programeve kompjuterike të ndryshme – në vendndodhje apo në “cloud”, asistimin mbi printimin, përpunimin dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave dhe informacionit, asistimin mbi përdorimin e sistemeve operative, etj;

Menaxhimi dhe administrimi i Platformës Online të zhvillimit të proceseve të mësimdhënies në distancë të Universitetit, që përfshin administrim të bazës së të dhënave të përdoruesve dhe të aksesit, konfigurim dhe administrim të moduleve të përfshira në platformë si Azure Active Directory, Exchange, Sharepoint, Teams, Stream, Onedrive, paketa Office, etj. Moment të rëndësishëm përbën administrimi dhe përpunimi i të dhënave analitike periodike të përdorimit të platformës dhe shërbimeve nëpërmjet modulit Power BI, ashtu si edhe krijimi i mundësive për monitorimin e proceseve të mësimdhënies nga ana e Sekretarive Mësimore në Dekanate në shërbim të evidentimit dhe rritjes së cilësisë. Njëkohësisht angazhimi ynë përfshin trajnimin dhe mbështetjen teknike për të gjitha çështjet e lidhura me përdorimin e kësaj platforme nga përdoruesit;

Angazhim si Sekretariat Teknik pranë Këshillit të Etikës së Universitetit, trajtim i punimeve shkencore përmes platformës Anti-Plagjiaturë të vënë në dispozicion nga MASR dhe RASH, administrim i raporteve të ngjashmërisë dhe i certifikimit elektronik;

Administrimi, përditësimi në nivel softuer dhe pasurimi me funksionalitete i të dy sistemeve elektronike të Bibliotekës Shkencore, a) Sistemi i Menaxhimit të Integruar, dhe b) Sistemi i Arkivit Digjital. Gjithashtu administrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave në rrjet të ruajtjes së arkivave multimediale;

Administrimi i serverit të vënë në dispozicion të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve për mbajtjen e kopjeve rezervë të dokumenteve dhe të dhënave;

Organizimi i mbledhjeve, seminareve, trajnimeve, etj., në funksion të rritjes së ndërveprimit dhe cilësisë së edukimit me në bazë Teknologjinë e Informacionit;

Si dhe gjithashtu mbështetja në drejtim të Teknologjisë së Informacionit sipas nevojave të parashtruara për realizimin e aktiviteteve të veçanta të Universitetit.

Spektori i Teknologjisë së Informacionit është i përkushtuar për realizimin e angazhimeve, duke ngulmuar në shërbim cilësor, të shpejtë dhe korrekt. Te gjitha aktivitetet dokumentohen.

Gjithashtu Spektori i TI ka treguar gatishmëri të vazhdueshme për nevoja të lidhura me aktivitete të veçanta të realizuara në Universitet.

RISKU - PROBLEMATIKAT QË MUND TË SHFAQEN GJATË VITIT PASUES

Spektori i TI vendos sërish theksin në faktin se në përgjithësi në postet e punës së administratës së Universitetit hasen vështirësi të lidhura me njësitë kompjuterike të amortizuara, ashtu si edhe vështirësi të tjera që paraqiten për të gjithë Universitetin si pasojë e infrastrukturës së TI aktualisht në dispozicion, infrastrukturë e cila ka nevojë për investime të qenësishme.

Këto kërkesa për investime, në mënyrë të detajuar dhe sistematike janë paraqitur në Rektorat, të përqendruara pikat kryesore, si më poshtë vijon:

1. Blerje pajisjesh të reja kompjuterike për stafin administrativ dhe personelin akademik dhe ndihmës akademik në Rektorat, Dekanate dhe Bibliotekë, pasi pajisjet kompjuterike të disponuara në 80% të rasteve paraqesin një vjetërsi të madhe dhe aktualisht janë të zhvlerësuar, bazuar në normën e amortizimit 25% në vit për kategorinë ku bëjnë pjesë, në performancën e dobët që këto pajisje paraqesin në krahasim me standardet dhe programet në përdorim të kohës, si dhe në pamundësinë e riparimit të tyre për arsye përtej ndërrimit të elementeve të konsumueshme.

Shënim: Kjo pikë është aktualisht në proces përditësimi me adresimin që iu bë përmes realizimit në muajin Shtator të procedurës së prokurimit për pajisje kompjuterike – aktualisht nën vlerësim.

2. Zbatimi i një infrastrukture të rrjetit kompjuterik të standardeve bashkëkohore, nëpërmjet zbatimit të konektivitetit hibrid fibër optike/ kabëll lan cat7, për të kompletuar në tërësi ndërlidhjen e komunikimit të të dhënave elektronike të kampusit Universitar si dhe çdo ambienti në përbërje të këtij kampusi, plotësuar me pajisjet përkatëse profesionale të ndërlidhjes/ adresimit/ sigurisë/ kontrollit të cilësisë.

Shënim: Kjo pikë është aktualisht në proces përditësimi. Me zbatimin e infrastrukturës së re për Korpusin Qendror, standardet për këtë pjesë të kampusit janë përmirësuar ndjeshëm.

3. Zbatimi i një infrastrukture pa kablllo "wireless" për kampusin Universitar me administrim të qendëruar, nëpërmjet zbatimit të një sistemi të plotë të konektivitetit me valë të përbëre nga transmetuesit dhe njësia qendrore e koordinimit/ adresimit/ kontrollit të cilësisë, në mënyrë që të mundësohet mbulim i plote dhe efikas i kampusit me këtë shërbim.
4. Zbatimi i një sistemi telefonie për zyrat e Institucionit, të standardit VOIP.
5. Përcaktimi i një ambienti të dedikuar për bazën e të dhënave elektronike të Universitetit (Dhomë Serverash), si dhe me tej investimi për pajisjen e këtij ambienti me infrastrukturën mbështetëse në drejtim të kushteve të lagështisë, temperaturës, ndriçimit/ ventilimit natyral, energjisë elektrike, elementeve fizike për vendosjen e pajisjeve qendrore në bazë të TI, sigurisë fizike dhe elektronike të hyrjes në të, etj.

Shënim: Kjo pikë është aktualisht në proces përditësimi. Me ambientin e marrë në dorëzim tek Korpusi Qendror pas rikonstruksionit të këtij të fundit, kjo pikë adresohet në mënyrë të qenësishme.

6. Investimi për zbatimin e një strukture komunikimi të kompletuar të të dhënave elektronike brenda Institucionit në standardin "Active Directory" me "Domain Controller" dhe "Roaming Profile", i cili të konsistojë në blerjen e dy Serverëve profesionalë me konfigurim për redundancë të plotë, dhe në kontraktimin për zbatimin e kësaj strukture komunikimi nga palë të treta, duke përfshirë mirëmbajtjen të paktën 5 vjeçare.
7. Investimi për ndërtimin e një portali të ri bashkëkohor Universitar, si portë kryesore identifikuese dhe reklamuese e Universitetit në domain-in virtual dhe si rrugëkalim kryesor i shkëmbimit të informacionit ndërmjet grupeve të interesit, shërbim i cili të kontraktohet me palë të treta, duke parashikuar edhe mirëmbajtjen të paktën 5 vjeçare.

Shënim: Kjo pikë është aktualisht në proces zbatimi dhe pritet të përmbyllet gjatë muajit Janar, 2021.

8. Investim për blerjen e njësive të reja multi-funksionale të printimit me kapacitet për zyra të mëdha dhe me funksion autentifikimi. Përndryshe, alokimi i një fondi më të madh për buxhetin vjetor në shërbim të mirëmbajtjes së pajisjeve aktuale të printimit dhe zbatimi i një standardi shërbimi të marrë nga palë të treta me kontratë vjetore. Në të kundërt, investimi për zbatimin e një sistemi të menaxhuar printimi për Universitetin të kontraktuar nga palë të treta si shërbim "outsorce" me bazë vjetore.

Shënim: Kjo pikë është aktualisht në proces përditësimi me adresimin që iu bë përmes realizimit në muajin Shtator të procedurës së prokurimit për pajisje kompjuterike – aktualisht nën vlerësim.

9. Alokimi i një fondi më të madh për buxhetin vjetor të Sektorit TI në shërbim të mirëmbajtjes së Serverëve, pajisjeve kompjuterike dhe infrastrukturës kompjuterike të institucionit. Në të kundërt investimi për kontraktimin e këtyre shërbimeve nga pale te treta si shërbim "outsorce" me baze vjetore.
10. Investimi për ndërtimin e një sistemi të arkivimit fizik (me barkodim) dhe digjital të dokumentacionit të Drejtorisë së BNJ, Informacionit dhe Protokol-Arkivit.

Shënim: Kjo pikë është aktualisht në proces studimi.

**TABELA E NGARKESËS MËSIMORE E REALIZUAR NGA STAFI AKADEMIK
PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018 / 2018-2019 / 2019-2020**

NR.	STAFI AKADEMIK SIPAS TITUVJE	1			2			3			(1 - 2)			(2 - 3)		
		VITI AKADEMIK 2017 - 2018			VITI AKADEMIK 2018 - 2019			VITI AKADEMIK 2019 - 2020			DIFERENCA NË NUMËR (STAF I BRENDSHËM)	DIFERENCA E NGARKESËS TOTALE	DIFERENCA E NORMËS VJETORE	DIFERENCA NË NUMËR (STAF I BRENDSHËM)	DIFERENCA E NGARKESËS TOTALE	DIFERENCA E NORMËS VJETORE
NUMRI I STAFIT AKADEMIK TË BRENDSHËM	NGARKESA TOTALE (NË ORË MËSIMORE) E REALIZUAR NGA STAFI BRENDSHËM	NORMA VJETORE (NË ORË MËSIMORE) PËR STAFIN AKADEMIK I BRENDSHËM	NUMRI I STAFIT AKADEMIK TË BRENDSHËM	NGARKESA TOTALE (NË ORË MËSIMORE) E REALIZUAR NGA STAFI BRENDSHËM	NORMA VJETORE (NË ORË MËSIMORE) PËR STAFIN AKADEMIK I BRENDSHËM	NUMRI I STAFIT AKADEMIK TË BRENDSHËM	NGARKESA TOTALE (NË ORË MËSIMORE) E REALIZUAR NGA STAFI BRENDSHËM	NORMA VJETORE (NË ORË MËSIMORE) PËR STAFIN AKADEMIK I BRENDSHËM	DIFERENCA NË NUMËR (STAF I BRENDSHËM)	DIFERENCA E NGARKESËS TOTALE						
	Totali (A+B+C)	304	71557.095	56080	298	65954	41375	310	66569	43315	6	5603.1	14705	-12	-615	-1940
A	Autoritetet të UART	18	5918.65	2380	18	5058	1460	18	5058	1460	0	860.65	920	0	0	0
1	REKTOR	1	150	50	1	90	50	1	90	50	0	60	0	0	0	0
2	ZËVENDËS REKTOR	2	652.05	140	2	567	120	2	822	120	0	85.05	20	0	-255	0
3	DEKAN	3	684.6	210	3	594	210	3	638	210	0	90.6	0	0	-44	0
4	ZËVENDËS DEKAN	3	1041.6	450	3	934	270	3	930	270	0	107.6	180	0	4	0
5	PËRGJEGJËS DEPARTAMENT I	9	3390.4	1530	9	2873	810	9	3082	810	0	517.4	720	0	-209	0
B	Stafi akademik me kohë të plotë	128	46746.295	30000	144	45997	23595	148	44328	24575	-16	749.29	6405	-4	1669	-980
1	PROFESOR	38	13283.05	7600	37	9794	5180	32	10411	4505	1	3489.1	2420	5	-617	675
2	PROFESOR I ASOCIUAR	32	12340.25	7040	32	11427	4480	30	11035	4200	0	913.25	2560	2	392	280
3	DOCENT	7	2395.62	2100	0	0	0				7	2395.6	2100	0	0	0
4	LEKTOR I PARË (DOC+DOKTOR)	9	3424.9	2340	23	7610	3795	28	2631	4620	-14	-4185	-1455	-5	4979	-825
5	LEKTOR	42	15302.475	10920	52	17166	10140	58	20251	11250	-10	-1864	780	-6	-3085	-1110
Nr.	STAFI AKADEMIK SIPAS TITUVJE	NUMRI I STAFIT AKADEMIK ME KOHË TË PJESHME	NGARKESA VJETORE TOTALE (NË ORË MËSIMORE) E REALIZUAR NGA STAFI AKADEMIK ME KOHË TË PJESHME	NORMA VJETORE (NË ORË MËSIMORE) ME KOHË TË PJESHME	NUMRI I STAFIT AKADEMIK ME KOHË TË PJESHME	NGARKESA VJETORE TOTALE (NË ORË MËSIMORE) E REALIZUAR NGA STAFI AKADEMIK ME KOHË TË PJESHME	NORMA VJETORE (NË ORË MËSIMORE) ME KOHË TË PJESHME	NUMRI I STAFIT AKADEMIK ME KOHË TË PJESHME	NGARKESA VJETORE TOTALE (NË ORË MËSIMORE) E REALIZUAR NGA STAFI AKADEMIK ME KOHË TË PJESHME	NORMA VJETORE (NË ORË MËSIMORE) ME KOHË TË PJESHME	DIFERENCA NË NUMËR (STAF I FTUAR)	DIFERENCA E NGARKESËS TOTALE	DIFERENCA E NORMËS VJETORE	DIFERENCA NË NUMËR (STAF I FTUAR)	DIFERENCA E NGARKESËS TOTALE	DIFERENCA E NORMËS VJETORE
C	Stafi akademik me kohë të pjeshme	158	18892.15	23700	136	14899	16320	144	17183	17280	22	3993.2	7380	-8	-2284	-960
1	PROFESOR	9	809.1	1350	6	425	720	11	1160	1320	3	384.1	630	-5	-735	-600
2	PROFESOR I ASOCIUAR	6	829.5	900	5	461	600	5	511	600	1	368.5	300	0	-50	0
3	DOCENT	0	0	0	0	0	0				0	0	0	0	0	0
4	LEKTOR I PARË (DOC+DOKTOR)	19	2034.4	2850	19	1356	2280	20	1758	2400	0	678.4	570	-1	-402	-120
5	LEKTOR	124	15219.15	18600	106	12657	12720	108	13754	12960	18	2562.2	5880	-2	-1097	-240

ANALIZË PËR VEPRIMTARINË EKONOMIKE TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE PËR VITIN 2019

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.5.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit Plotësues nr. 1 datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019” i ndryshuar, paragrafi VI “Monitorimi” si dhe Udhëzimi nr. 22 datë 17.11.2016 “Për Procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, Ligjit nr.1 0296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile/nëpunësve....”, VKM nr. 202, datë 5.03.2017 “Për pagat e punonjësve mbështetës.....”, VKM nr. 268, datë 29.03.2017 “Për trajtimin me page dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë” dhe shkresës së MASR Nr. 763, datë 16.10.2014 “Për miratimin e numrit të punonjësve”, Universiteti i Arteve, për 12-mujorin e vitit 2020, ka menaxhuar dhe vlerësuar me përparësi të veçantë procesin e monitorimit të zbatimit të fondeve.


Buxheti për vitin 2019 është miratuar nga strukturat vendimmarrëse Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, bazuar në burimet e financimit, të cilat paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Në lekë

Art.	Emërtimi	Kapitulli Nr. 1	Kapitulli Nr. 6	Kapitulli Nr. 8	TOTALI
231	Investime	33,358,577	34,267,516	-	67,626,093
600	Paga	-	11,947,355	271,803,833	283,751,188
601	Sigurime shoqëror dhe shëndet.	-	1,681,689	42,078,318	43,760,007
602	Mallra dhe shërbime të tjera	-	2,569,580	37,023,018	39,592,598
605	Transferimet korrente jashtë	-	-	242,310	242,310
606	Ndihme për individe	-	-	1,432,768	1,432,768
606	Bursa	-	-	22,877,994	22,877,994
	TOTALI	33,358,577	50,466,140	375,458,241	459,282,958

Shënim: Kapitulli Nr. 1 (Buxheti i shtetit për investime), Kapitulli Nr. 6 (Te ardhurat e UA), Kapitulli Nr. 8 (Granti i mësimdhënies)


Pesha specifike, që zë çdo kapitull i buxhetit, në buxhetin total të viti 2020, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



Realizimi i buxhetit të Universitetit të Arteve, për vitin 2020 është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Art.	Emërtimi	Plani Viti 2020	Fakti Viti 2020	Diferenca P-F	% e realizimit
231	Investime	67,626,093	48,640,609	18,985,484	72%
600	Paga	283,751,188	282,449,449	1,301,739	100%
601	Sigurime shoqëror dhe shëndet.	43,760,007	43,526,900	233,107	99%
602	Mallra dhe shërbime te tjera	39,592,598	27,630,198	11,962,400	70%
605	Transferimet korrente jashtë	242,310	242,310	-	100%
606	Ndihma për individë	1,432,768	1,432,768	-	100%
606	Bursa për studentë	22,877,994	11,811,846	11,066,148	52%
TOTALI		459,282,958	415,734,080	43,548,878	91%

Pesha specifike e çdo zëri të shpenzimeve, në shpenzimet totale të realizuara gjatë vitit 2020, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



Në tabelën e mëposhtme është paraqitur realizimi i buxhetit për vitin 2020, bazuar në burimet e financimit.

Në 000 lek

Art.	Emërtimi	Kapitulli Nr.1		Kapitulli Nr.6		Kapitulli Nr.8		TOTALI	
		Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plani	Fakti
231	Investime	33,359	33,359	34,268	15,282	-	-	67,626	48,641
600	Paga	-	-	11,947	10,646	271,804	271,804	283,751	282,449
601	Sigurime shoqer. & shëndet.	-	-	1,682	1,449	42,078	42,078	43,760	43,527
602	Mallra dhe shërbime të tjera	-	-	2,570	2,570	37,023	25,061	39,593	27,630
605	Transferimet korrente jashtë	-	-	-	-	242	242	242	242
606	Ndihme	-	-	-	-	1,433	1,433	1,433	1,433
606	Bursa	-	-	-	-	22,878	11,812	22,878	11,812
	TOTALI	33,359	33,359	50,466	29,946	375,458	352,430	459,283	415,734

INVESTIME (231)

Për vitin 2020, miratuar me vendimet e Bordit të Administrimit, investimet e parashikuara dhe të realizuara, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Plani (P)	Fakti (F)	Tëprica (P-F)	% e realizimit
		Viti 2020	Viti 2020		
1	Rikonstruksion i korpusit kryesor	39,343,853	39,343,853	-	100%
2	Rikonstr. i korpusit kryesor (Kolaudim)	77,520	77,447	73	100%
3	Rikonstruksion i korpusit kryesor (Supervizim)	199,989	199,989	-	100%
4	Kondicioner	200,000	101,400	98,600	51%
5	Kompjuter, Printer, fotokopje	9,039,821	7,681,920	1,357,901	85%
6	Programe kompjuterike	738,400	638,400	100,000	86%
7	Pajisje elektroshtepiake	910,000	597,600	312,400	66%
8	Vegla muzikore	5,557,634	-	5,557,634	0%
9	Pajisje audivizuale	960,000	-	960,000	0%
10	Mobilim	740,000	-	740,000	0%
11	Pajisje teknike	9,858,876	-	9,858,876	0%
	TOTALI	67,626,093	48,640,609	18,985,484	72%

1. Realizimi për zërat “Kondicioner” në masën 51%, “Kompjuter, Printer, fotokopje” në masën 85%, “Programe kompjuterike” në masën 86% “Pajisje elektroshtepiake” në masën 66% ka ardhur si rrjedhojë e raportit kërkesë–ofertë, mbasi përzgjedhja e fituesve për realizimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve është mbështetur në procedurat e prokurimit publik online.

2. Mosrealizimi i zërit “Vegla muzikore”, ne te cilin ishin parashikuar blerje vegla muzikore për Fakulteti e Muzikës, erdhi si pasojë se megjithëse u hodh për tenderim 2 here, blerja nuk u realizua, mbasi ofertuesit u tërhoqën.

3. Mosrealizimi i zërit “Pajisje audio vizuale”, ne te cilin ishin parashikuar blerje pajisje audio vizuale për Fakultetin e Muzikës, erdhi si pasojë se megjithëse u hodh për tenderim, blerja nuk u realizua, mbasi ofertuesit u tërhoqën.

4. Për zërat “Pajisje teknike” mos realizimi i fondeve ka ardhur si pasojë e mungesës së fondeve për arsyet të cilat do të trajtohen në seksionin “Të ardhura”.

PAGA (600)
SIGURIMET SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE (601)

Në lekë

Art.	Emërtimi	Plani (P) Viti 2020	Fakti(F) Viti 2020	Diferenca P-F	% e realizimit
600	Paga	283,751,188	282,449,449	1,301,739	99.54%
601	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	43,760,007	43,526,900	233,107	99.47%
	TOTALI	327,511,195	325,976,349	1,534,846	99.53%

“Paga” dhe “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” – shpenzimet e këtyre zërave, për vitin 2020, miratuar nga Bordit i Administrimit. Më lartë janë përfshinë pagesa për:

- Personelin e brendshëm (numri mesatar i punonjësve të punësuar për vitin 2020 ishte 235 nga 300 punonjës që është në strukturën e miratuar të UART), i cili zë rreth 87.7% të fondit të realizuar për paga.
- Personelin e ftuar akademik për punën e realizuar për vitin akademik 2019-2020 dhe punonjës administrativ te përkohshëm, që zë rreth 3.8 % të fondit të realizuar për paga.
- Orët mbinormë të personelit akademik të brendshëm për vitin akademik 2019-2020, që zë rreth 8.5 % të fondit të realizuar për paga. Pagesat për orët mbinormë nuk janë realizuar të plota mbasi ka patur mungesë fondi për vitin 2020.

MALLRA DHE SHËRBIME (602)

Për vitin 2020, miratuar nga Bordi i Administrimit, mallra dhe shërbime, parashikuara dhe të realizuara, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në lekë


Nr. llog.	Emërtimi	Plani (P) Viti 2020	Fakti (F) Viti 2020	Teprica (P-F)	% e realizimit
6020	Mallra dhe shërbime të tjera	2,110,000	598,848	1,511,152	28%
6021	Materiale dhe shërbime speciale	360,000	220,734	139,266	61%
6022	Shërbime nga të tretë	17,288,744	12,166,376	5,122,368	70%
6023	Shpenzime transporti	170,000	132,529	37,471	78%
6024	Shpenzime udhëtimi	1,000,000	-	1,000,000	0%
6025	Shpen. për mirëmbajtje te zakonshme	1,632,000	816,480	815,520	50%
6029	Shpenzime të tjera operative	17,031,854	13,695,231	3,336,623	80%
		39,592,598	27,630,198	11,962,400	70%

- **Shënim:** Zërat e shpenzimeve të tabelës së mësipërme janë të pasqyruar ne Tabelën Nr. 1

Zëri “Mallra dhe shërbime të tjera”– mosrealizimi ka ardhur për arsyet që paraqiten në vijim.

1. **“Mallra dhe shërbime të tjera”** – ky zë nuk u realizua kryesisht për 2 arsye. Nuk u realizua blerja për “Materiale për funksionimin e pajisjeve speciale – pjesë këmbimi për piano” me vlerë 960.000 lekë, mbasi nuk lindi domosdoshmëria, kjo konfirmuar edhe nga Fakulteti i Muzikës. Arsyeja e dytë është si rrjedhojë e raportit kërkesë–ofertë, mbasi përzgjedhja e fituesve për realizimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve është mbështetur në procedurat e prokurimit publik.
2. **“Materiale dhe shërbime special”** - ky zë nuk u realizua kryesisht se nuk pati kërkesë nga ana e fakulteteve për prodhim libra dhe publikime profesionale, me vlerë 120.000 lekë, në funksion të kërkimit shkencor.
3. **“Shërbime nga të tretë”** - ky zë nuk u realizua kryesisht se pati shpenzime më pak, kushtëzuar nga situatë e krijuar nga Covid-19, për zërat energji elektrike , ujë, karburant për ngrohje.
4. **“Shpenzime transporti”** - ky zë nuk u realizua si rrjedhojë e raportit kërkesë–ofertë, mbasi përzgjedhja e fituesve për realizimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve është mbështetur në procedurat e prokurimit publik.
5. **“Shpenzime udhëtimi”** - ky zë nuk u realizua se nuk pati kërkesë nga ana fakulteteve për shpenzime për udhëtim jashtë dhe Brenda vendit, kjo kushtëzuar nga situatë e krijuar nga Covid-19.
6. **“Shpenzimet për mirëmbajtje të zakonshme”** - ky zë nuk u realizua për 2 arsye:
 - Nuk u realizuan shërbimet për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore si dhe rrjeteve hidraulike, elektrike, me vlerë 480.000 lekë mbasi nuk lindi nevojë e specializuar për këto mirëmbajtje. Nevojat u plotësuan nga sektori i shërbimeve në UA.
 - Si rrjedhojë e raportit kërkesë–ofertë. Përzgjedhja e fituesve për realizimin e mallrave dhe shërbimeve është mbështetur në procedurat e prokurimit publik.
7. **“Shpenzime të tjera operative”** - ky zë nuk u realizua kryesisht nga arsyet e mëposhtme:
 - Nuk u realizuan blerjet për materiale për FAB me vlerë 960.000 lekë, mbasi nuk pati kërkesa.
 - Nuk u realizuan blerjet për materiale ndërtimi dhe të ngashme me vlerë 960.000 lekë mbasi nuk lindi domosdoshmëria, nisur edhe nga situata e krijuar.
 - Nuk u realizua shpenzimi për sigurimin ndërtesave, mbasi Korpusi Kryesor ishte në proces rikonstruksioni dhe realizimin i kësaj procedure nuk përfundonte brenda afateve të kërkuara.
 - Shpenzime për honorare – modele pozimi u realizuan më pak, sepse procesi mësimor u realizua kryesisht online.
 - Si rrjedhojë e raportit kërkesë–ofertë, mbasi përzgjedhja e fituesve për realizimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve, është mbështetur në procedurat e prokurimit publik.

Pesha specifike që zë çdo shpenzim, në shpenzimet totale të realizuara për mallra dhe shërbime, gjatë vitit 2020 është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:




TE ARDHURAT

Të ardhurat e realizuara nga Universiteti i Arteve, gjatë vitit 2020, janë si në vijim:

Nr.	Burimi i krijimit i te ardhurave	Plani (P) Viti 2020	Fakti(F) Viti 2020	Diferanca P-F	% e realizimit
1	Tarifa Shkollimi	37,686,800	35,518,210	(2,168,590)	94%
2	Tarife konkurrimi & regjistrimi	2,897,000	2,845,900	(51,100)	98%
3	Shërbim salle	200,000	-	(200,000)	0%
4	Qera ambiente	2,249,340	2,279,280	29,940	101%
5	Diploma, vërtet., shtypshk etj	470,000	346,300	(123,700)	74%
TOTALI		43,503,140	40,989,690	(2,513,450)	94%

- Zëri “Tarifa shkollimi” - mosrealizimi i këtij zëri, ka ardhur kryesisht si pasojë e përjashtimeve/reduktimeve nga tarifa e shkollimit, bazuar në VKM e nxjerra për këtë qëllim, si dhe nga mos frekuentimi i shkollës duke sjelle si pasojë mos pagesën e tarifës së shkollimit.
- Zëri “Shërbim salle” - mosrealizimi i këtij zëri ka ardhur si pasojë se për periudhën Janar-Shkurt 2020 ishte në rikonstruksion Korpusi Kryesor, ndërsa në vazhdim nuk mund të jepeshin sallat nga situata e krijuar nga Covid-19.

Pesha specifike që zë çdo burim, në të ardhurat totale të realizuara gjatë vitit 2020, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të ardhurat e realizuara në vitin 2020, krahasuar me ato të vitit 2019.

Nr.	Burimi i krijimit i te ardhurave	Viti 2019 (lek)	Viti 2020 (lek)	Diferanca 2020-2019	% e rritjes
1	Tarifa Shkollimi	32,462,078	35,518,210	3,056,132	9.41%
2	Tarife konkurrimi & regjistrimi	2,915,400	2,845,900	(69,500)	-2.38%
3	Shërbim salle	1,820,000	-	(1,820,000)	-100.00%
4	Qera ambiente	1,479,280	2,279,280	800,000	54.08%
5	Diploma, vërtet., shtypshk etj	504,727	346,300	(158,427)	-31.39%
	TOTALI	39,181,485	40,989,690	1,808,205	4.61%

TE TJERA

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e realizuara për vitin 2020, krahasuar me vitin 2019.

Art.	Emërtimi	Shpenzime Viti 2019	Shpenzime Viti 2020	Diferenca 2020-2019	Në lekë
					% e rritjes
231	Investime	103,247,082	48,640,609	(54,606,473)	-52.89%
600	Paga	281,004,546	282,449,449	1,444,903	0.51%
601	Sigur. shoqer. dhe shëndet.	42,385,154	43,526,900	1,141,746	2.69%
602	Mallra & shërbime	26,366,620	27,630,198	1,263,579	4.79%
605	Transferimet korrente jashtë	122,830	242,310	119,480	100.00%
606	Bursa për studentët	6,878,115	11,811,846	4,933,731	71.73%
606	Transf. për buxhetet e individ.	640,225	1,432,768	792,543	123.79%
606	Rimbursim tarifë shkollimi	405,000	-	(405,000)	-100.00%
	TOTALI	461,049,572	415,734,080	(45,315,491)	-9.83%

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur shpenzimet e realizuara për vitin 2020, krahasuar me vitin 2019.




Tabela Nr.1

Në lekë

Nr. llog.	Emërtimi	Plani (P) Viti 2020	Fakti(F) Viti 2020	Teprica (P-F)	% realizimit
6020100	Kancelari	250,000	132,600	117,400	53%
6020200	Materiale për pastrim dezinfektim ngrohje ndriçim	360,000	119,208	240,792	33%
6020300	Materiale për funksionimin e pajisjeve te zyrës	180,000	68,040	111,960	38%
6020400	Materiale për funksionimin e pajisjeve speciale	960,000	-	960,000	0%
6020900	Furnizime dhe materiale te tjera zyre	360,000	279,000	81,000	78%
6020	Mallra dhe shërbime të tjera	2,110,000	598,848	1,511,152	28%
6021007	Libra dhe publikime profesionale	120,000	-	120,000	0%
6021010	Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik	120,000	119,934	66	100%
6021099	Te tjera materiale dhe shërbime speciale	120,000	100,800	19,200	84%
6021	Materiale dhe shërbime speciale	360,000	220,734	139,266	61%
6022001	Energji elektrike	5,000,000	3,030,891	1,969,109	61%
6022002	Ujë	1,200,000	748,310	451,690	62%
6022003	Shërbime telefonike	560,000	510,243	49,757	91%
6022004	Shërbime postare	10,000	5,397	4,603	54%
6022005	Shërbim ngrohje	2,000,000	-	2,000,000	0%
6022007	Shërbime bankare	10,000	3,075	6,925	31%
6022008	Shërbime te sigurimit dhe ruajtjes	7,868,460	7,868,460	-	100%
6022010	Shërbime te printimit dhe publikimit	120,000	-	120,000	0%
6022099	Shërbime te tjera	520,284	-	520,284	0%
6022	Shërbime nga të tretë	17,288,744	12,166,376	5,122,368	70%
6023100	Karburant	100,000	85,200	14,800	85%
6023300	Shpenzime për Siguracion për makina	70,000	47,329	22,671	68%
6023	Shpenzime transporti	170,000	132,529	37,471	78%
6024100	Udhëtim brenda vendit	500,000	-	500,000	0%
6024200	Udhëtim jashtë vendit	500,000	-	500,000	0%

6024	Shpenzime udhëtimi	1,000,000	-	1,000,000	0%
6025300	Shpenzime për mirëmbajtje objekteve ndërtimore	360,000	-	360,000	0%
6025400	Shpenzime mirëmbajtje rrjeteve hidraulike elektrike	120,000	-	120,000	0%
6025500	Shpenzime mirëmbajtje Pajisjeve, veglave te punës	840,000	619,200	220,800	74%
6025600	Shpenzime për mirëmbajtje mjeteve te transportit	72,000	-	72,000	0%
6025800	Shpenzime për mirëmbajtje Pajisje zyre	240,000	197,280	42,720	82%
6025	Shpen. për mirëmbajtje te zakonshme	1,632,000	816,480	815,520	50%
6029001	Shpenzime për pritje përcjellje	120,000	-	120,000	0%
6029004	Shpenzim sigurim ndërtese	480,000	-	480,000	0%
6029005	Shpenzime për honorare	12,524,580	11,733,007	791,573	94%
6029008	Shpenzime tatim dhe taksa	850,000	827,744	22,256	97%
6029099	Shpenz. te tjera materiale dhe shërbime operative	3,057,274	1,134,480	1,922,794	37%
6029	Shpenzime të tjera operative	17,031,854	13,695,231	3,336,623	80%
	TOTALI	39,592,598	27,630,198	11,962,400	70%

Miratuar me

VENDIM TË SENATIT AKADEMIK

të Universitetit të Arteve

Nr. _____ datë _____ / _____ /2021